

Prof. Dr. Marenglen VERLI

DOKUMENTE: MEMORANDUM MBI SHQIPËRINË*

Kohët ndryshojnë dhe superfuqitë politike e ekonomike botërore të interesuara për rajonin e Ballkanit i kanë lenë vendin njera-tjetrës, por ajo që mbetet konstante është një dëshirë e përhershme e të mëdhenjve, pavarësisht nga oshilacionet për prani në këtë trevë.

Mbeten natyrisht edhe popujt e rajonit që, me ose pa aleatë të mëdhenj në miqësi ose armiqësi me njeri tjetrin, u duhet të mbijetojnë e të përpiqen për një jetë më të mirë duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë që u jepen dhe të gjithë resurset që zotërojnë.

Nga distanca e një periudhe historike gati 130 vjeçare dy dokumente arkivore shumë interesante të diplomacisë austro-hungareze që datojnë në vitin 1877, një memorandum mbi Shqipërinë përgjithësisht, si edhe një raport mbi Kosovën, që merr shkas nga riorganizimi administrativ i saj, të hartuara prej kontit Lipih, konsull i njohur i Perandorisë Austro-Hungareze, na japin mundësi jo vetëm të gjykojmë për interesimin e jashtëzakonshëm të Vjenës për trevat shqiptare dhe kombin shqiptar, por edhe të marrim një informacion kompleks. Ky informacion hedh mjaft dritë mbi situatën politike, ekonomike, demografike, etnike, konfesionale, sociale, arsimore, kulturore, legislative, mbi raportet ndërnacionale, traditat, tiparet kombëtare të shqiptarëve por edhe të fqinjëve të tyre sllavë, etj., banorë të njësive administrative të kohës, që janë konsideruar si sanxhaqe ose vilajete shqiptare.

* AIH. Vj, 29-8 (HHSTA, PA, A, Nr. 1124), “ Memorandum mbi Shqipërinë” prej konsullit perandorak dhe mbretëror Lipih (Vjenë, më 20 qershor 1877). Protokollit dhe Arkiva për korrespondencën politike të Ministrisë së Jashtme perandorake dhe mbretërore.

Pas një kohe kaq të gjatë që nga viti i hartimit të dy materialeve të sipërpërmendura, konstatohet pa vështirësi progresi i shqiptarëve dhe kombeve të tjerë të rajonit, fqinjë me ta, por edhe problemet e pazgjidhura të ngjashme në të dy periudhat, edhe ngjashmëria në llogaritjen e ballkanasve në kombinacionet dhe gjeostrategjinë e të mëdhenjve me interesa në rajon.

Në këtë kuadër në përplasjen midis Lindjes dhe Perëndimit konstatohet vazhdimësia e pranisë ruse, që këmbëngul të luajë rolin e protektoratit të sllavëve të Gadishullit.

Nëse do të përmendim më tej dhe më imtësisht vlerën e dokumenteve të përgatitura nga diplomati austriak në vitin 1877, duhet theksuar se të një rëndësie të veçantë janë të dhënat për situatën demografike në sanxhakun e Nishit, i cili pas okupimit e më pas aneksimimit nga Serbia, në vitet 1877-1878 u spastrua etnikisht në mënyrë tërësore nga popullsia shqiptare. Diskutime e prononcime të shumta, krejt të kundërta, ndonjëherë edhe brenda ambienteve akademike, lidhur me numrin e shqiptarëve të shpërngulur, i japin informacionit të Lipih-ut për situatën demografike të këtij sanxhaku para pushtimit serb dhe para shpërnguljes që pasoi, një vlerë të veçantë.

Është i njohur fakti se edhe pse në Kongresin e Berlinit, Fuqitë e Mëdha vendosën respektimin e të drejtave të dhjetëra mijëra refugjatëve të pafajshëm shqiptarë, të larguar nga vatrata e tyre gjatë dhe pas Luftës së Dytë Serbo-Osmane të zhvilluar në 13 dhjetor 1877 – 25 shkurt 1878, çka u sanksionua edhe në marrëveshjet midis Portës së Lartë dhe Beogradit, asgjë nuk u korigjua më pas dhe një territor prej 10972 km², i populluar masivisht nga shqiptarët në krahun verior dhe perëndimor të tij, u spastrua etnikisht përmes një politike zyrtare të institucionalizuar në çdo instancë.

Çfarë ndodhi dihet, pse ndodhi gjithashtu dihet, por të dhënat demografike në prag të shpërnguljes masive na mundësojnë të jemi afër të vërtetës për përmasat e asaj që ndodhi. Autorë të ndryshëm kanë për këtë pikëpamje të ndryshme*. Sipas tyre, vendbanime shqiptare të pastra ose të përziera kanë qenë në Sanxhakun e Nishit

* Shih Historia e Popullit Shqiptar, Botim nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 2002; Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë, Prishtinë 2004, etj.; Masar Rizvanolli, Lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore 1875-1878,

diku rreth 648 deri 703 vendbanime kurse numri i të shpërngulurve është dhënë nga 30 mijë (sipas Jovan Cvijiçit) në rreth 160 deri 200 mijë (sipas Sabit Ukës) e deri 300 mijë (sipas Shaban Brahës). Në botimin më të fundit kolektiv të historianëve shqiptarë “Historia e Popullit Shqiptar”, vëll. II, Tiranë, 2002, f. 148, pa specifikuar përbërjen kombëtare, jepen 100.000 të ardhur në vilajetin e Kosovës si pasojë e shpërnguljes nga zona e pushtimit serb, gati 38 mijë të ardhur në vilajetin e Manastirit të dëbuar nga ushtritë ruse e bullgare dhe 26 mijë të ardhur në vilajetin e Shkodrës për shkak të ndjekjes nga zona e pushtimit malazez.

Ndërkohë numri u përgjithshëm i shqiptarëve në sanxhakun e Nishit para shpërnguljes sipas të dhënave të ndryshme është dhënë nga 83 mijë – 110 mijë (Feliks Kantz, Carl Sax) deri në mbi 200 mijë (Sabit Uka).

Sa është në fakt numri i shqiptarëve që u shpërngulën në dimrin e viteve 1877-1878 nga Sanxhaku i Nishit? Hulumtimet e reja në arkivat e dokumenteve të kohës do të na afrojnë pa dyshim te e vërteta. Por edhe me informacionin që na jep Lipih mund t’i afrohem kësaj të vërtete.

Sipas të dhënave statistikore të ofruara nga diplomati i njohur në raportin e 17 marsit 1877, popullsia në vilajetin e Kosovës* në vitin 1877 përbëhej gjithsej nga 404.000 shqiptarë (389.000 myslimanë dhe 15000 katolikë) të shpërndarë përkatësisht në sanxhaqet e Prishtinës (96.500 shqiptarë), Prizrenit (202500 shqiptarë), Nishit (50.000 shqiptarë pa llogaritur Vranjën me 25.000 shqiptarë të përfshirë në sanxhakun e Prizrenit), Shkupit (35.000 shqiptarë) dhe Jeni Pazarit (20.000 shqiptarë).

* Gjakovë 2007; Jovan Hatxhi-Vasiljeviç, Arbanashka Liga – Arnautska Kongra i Srpski narod u Turskom Carstva (1878-1882), Beograd 1909; Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), Tiranë, 1989; Emin Pllana, Shkaqet dhe mënyra e shpërnguljes së muhaxhirëve shqiptarë nga territori i Sanxhakut të Nishit në Kosovë, në “Gjurmime Albanologjike” (seria historike) nr.IX, Prishtinë, 1980; Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995), Botim nga Instituti i Historisë i Kosovës, Prishtinë 1997, Shaban Braha: Gjenocidi serbomadhe dhe qëndresa shqiptare (1844-1990), Tiranë 1992, etj.

* Vilajeti i Kosovës në ndarjen administrative të sipërpërmendur u krijua në pranverën e vitit 1877 dhe ekzistoi për rreth 11 muaj.

Në këtë vilajet konsulli shënon edhe 370.000 bullgarë, 225.000 serbë, 71.000 myslimanë të tjerë, 13.000 çerkezë, 3000 vllahë, 2000 izraelitë dhe 15.500 të tjerë. Popullsia e përgjithshme llogaritet 1.111.500, nga të cilët 555.000 myslimanë, 556.500 të krishterë dhe 2000 hebrenj.

Përsa i përket Sanxhakut të Nishit pa kazanë e Vranjës (që me këtë ndarje i takonte Sanxhakut të Prizrenit) popullsia paraqitej në këtë mënyrë: shqiptarë (myslimanë) 50.000 (+25 mijë Vranja), bullgarë (ortodoksë) 77.000 (+60.000 Vranja), serbë (ortodoksë) 11.000, myslimanë të ndryshëm 10.000, çerkezë 4.000, myslimanë (?) 4000, izraelitë 800. Popullsia e përgjithshme e Sanxhakut (pa Vranjën) ishte 156.800 banorë, përkatësisht 68.000 myslimanë dhe 88.000 të krishterë. Po të shtohet edhe popullsia e Vranjës me 25.000 shqiptarë dhe 60.000 bullgarë, numri i popullsisë arrinte 241.800 banorë, nga të cilët 93.000 myslimanë dhe 148.000 të krishterë¹.

Në dokumentin tjetër të titulluar “Memorandum mbi Shqipërinë” dërguar Vjenës më 20 qershor 1877, konsulli F. Lipih shprehet: “Shqiptarët e Veriut ... që në kuptimin më të gjerë janë edhe banorët e Shqipërisë së Mesme ... banojnë në pashallëkun e Shkodrës, të Prizrenit, Dibërës, Jenipazarit, Nishit dhe Shkupit, pra aproksimativisht në viset e ish vilajetit të Prizrenit ...”

Sipas të dhënave statistikore të këtij dokumenti të dt. 20 qershor, Lipih shënon 798.250 shqiptarë në tërësinë e Shqipërisë së Veriut dhe 548.000 jo shqiptarë, pra një popullsi tërësore prej 1.345.000 banorësh.

Në Sanxhakun e Nishit sipas konsullit kazaja e Vranjës kishte 25.000 shqiptarë myslimanë, e Leskovcit 24.000 të tillë, e Prokuples 15.000 dhe e Kurshumlisë 19.000. Ndërkohë shënohen për Vranjën 60.500 bullgarë ortodoksë, për Nishin 35.500 bullgarë ortodoksë dhe 10.000 myslimanë të ndryshëm, për Leskovcin 22.500 bullgarë ortodoksë, për Prokuplen 19.500 serbë ortodoksë dhe për Kurshumlinë 1500 serbë ortodoksë.

Sipas këtyre të dhënave Sanxhaku i Nishit kishte 223.000 banorë, përkatësisht 139.000 jo shqipfolës (prej tyre 10.000 myslimanë) dhe 83.000 shqipfolës².

1 AIH, Vj. 29-16 (HHSTA,PA,A, Nr.9).

2 AIH, Vj. 29-8 (HHSTA,PA,A, nr. 104).

Nisur nga burime të tjera të cituara, S. Uka në vëllimin “Dëbimi...” f. 26, thekson se duhen shtuar në shifrën e përmendur edhe shqiptarët e Nishit dhe Pirotit që nuk janë përfshirë në statistikën e mësipërme, që sipas llogaritjeve të tij të përafërta arrinin rreth 27.000 banorë. Nëse këtë të dhënë e konsiderojmë të mirëqënë numri i përgjithshëm i shqiptarëve në Sanxhakun e Nishit do të arrinte në 110.000 banorët. Pikërisht ndërmyet shifrave 83.000 dhe 110.000, ose diçka më poshtë, duhet kërkuar numri i saktë i shqiptarëve të shpërngulur me dhunë nga Serbia në dimrin e viteve 1877-1878 e më pas, që gjithsesi është një shifër tepër e lartë po të merret parasysh niveli i popullimit të trevave ballkanike në këtë kohë.

Përveç informacionit të sipërpërmendur demografik, etnik, fetar etj., që na jep mundësi të konkludojmë edhe për numrin e shqiptarëve të shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit, konti Lipih ofron edhe shumë të dhëna të karakterit ekonomik e social të banorëve të rajonit rreth situatës politike, interesave të veçanta krejt të ndryshme të Austro-Hungarisë dhe Rusisë në trevat shqiptare, veçanërisht në ato të Shqipërisë Veriore e më gjerë, të cilat jepen aq qartë sa edhe sot raportet e konsullit austro-hungarez lexohen jo vetëm pa vështirësi por edhe me kënaqësinë që të jep një material i kësaj natyre i hartuar nga një diplomat shumë i përgatitur dhe i mirinformuar. Më poshtë po paraqiten integralisht dy raportet e sipërpërmendura.

*

*

*

Memorandum mbi Shqipërinë

Vjenë, më 20 qershor 1877

Në rrethanat e sotme kombi shqiptar duhet të konsiderohet si një faktor politik, i cili meriton të trajtohet me një zell më të madh dhe të çmohet sipas vlerës së tij të plotë. Kjo veçanërisht duhet marrë në konsideratë sa më afër që po duket rreziku i sllavizimit të Gadi-shullit Ballkanik, sepse të gjithë elementët, që janë të përshtatshëm për t'i vënë pritë këtij procesi, kanë një rëndësi të veçantë në këtë çast për politikën austro-hungareze të orientit, për të cilën sigurisht

nuk mund të jetë e pëlqyeshme perspektiva e riformimit të shteteve sllave, gjysëm ose krejtësisht sovrane, në kufirin juglindor të Perandorisë. Prandaj ajo është e detyruar të hyjë në kontakt të ngushtë me elementët jo sllavë të vendeve ballkanike, që ata t'i bëjë aleatë të besueshëm kundër tendencave, karakteri shkatërrues i të cilave me pasojat e fundit është drejtuar kundër ekzistencës së monarkisë. Ky karakter shfaqet jo vetëm i qartë por edhe agresiv, madje elementë të dyshimtë përpiqen të nënshtrojnë vetë serbo-bullgarizmin, i cili po përpin gjithçka, një rrethanë kjo që justifikon një bashkim të interesave shumë të afërta ndërmjet dy pjesëve.

Që të mund të vërehen si faktorë politikë të vërtetë, duhet që elementet josllavë të mos kenë karshi monarkisë thjesht rolin e nevojtarit për mbrojtje dhe ndihmë, që është pak dobiprurës, por të jenë në gjendje në rast aksioni të përdoren edhe si aleatë të dobishëm.

Para se të merremi përgjithësisht me këta elementë, është e këshillueshme që të njohim saktësisht si forcën e tyre numerike ashtu edhe aftësitë e tyre. Nga kjo pikëpamje kombi shqiptar që në rrethet e gjëra është akoma pak i njohur, si një faktor kryesor ndërmjet elementëve jo sllavë të gadishullit ballkanik, do t'i shtrohet këtu një shqyrtimi të shkurtër.

Duket se shqiptarët kanë me hungarezët të përbashkët faktin, se sllavizmi paraqitet për të dy si një rrezik i shpejtë. Këta të fundit, sidoqoftë, kanë përparësinë se janë kombëtarisht të bashkuar dhe kanë formuar një strukturë të rregullt shtetërore, e cila në faktorin gjerman të monarkisë ka një mbështetje të fortë, ndërsa shqiptarët janë të ndarë në dy fise, në të veriut dhe në të jugut. Secili prej tyre ende qëndron krejt i izoluar dhe me pjesën tjetër ka të përbashkëta vetëm shumë pak pika takimi. Raca shqiptare në më të shumtat e cilësive esenciale ju përngjan hungarezëve, veçanërisht banorët e Shqipërisë së Veriut. Ajo është konservatore fund e krye, e gjallë dhe, të paktën deri tashti, me sukses të dukshëm ja ka arritur të ruajë pavarësinë e saj kombëtare. Kjo racë është energjike, e guximshme dhe e lidhur me dashuri ndaj atdheut dhe institucioneve të vendit. Gjithashtu shqiptarit nuk mund t'i mohohet inteligjenca, aftësia për t'u edukuar dhe sensi i një këndvështrimi të drejtë në çështjet politike. Këtë e dëshmon përparimi shoqëror, që ata arrijnë kudo ku paraqiten kushte normale, të cilat favorizojnë zhvillimin e tyre; numri i konsiderueshëm i kapa-

citeteve ushtarake dhe politike që kanë dalë nga mesi i popullit dhe që kanë ditur të hipin në pozita të rëndësishme; janë takti dhe qëndrimet e rafinuara me të cilat edhe fiset malore më primitive dinë të dallojnë dhe të sigurojnë fitimin e tyre. Kjo rrethanë e fundit ishte kryesisht faktori që hodhi kombin shqiptar përkatësisht, masën më të madhe të tij, në krahët e islamizmit. I njëjti rast ishte edhe me fisnikët feudalë boshnjakë, energjikë dhe llogaritës të mirë, por në rastin e shqiptarëve, me diferencën esenciale se ndryshimi i besimit i një pjese të rëndësishme të kombit nuk i vuri aspak ata që mbetën me besimin e vjetër, në një gjendje inferiore karshi të parëve. Kështu ndërmjet shqiptarëve nuk ka pasur dhe as që ka një klasë sundonjëse dhe një të sunduar dhe nuk ekzistojnë zotërinj feudalë myslimanë, nga njëra anë dhe bujq të krishterë detyruar nga ana tjetër. Si të krishterët dhe myslimanët qëndrojnë karshi njësoj të pavarur dhe në pjesët e ndryshme të vendit njësoj i kundërvihen me zell presionit të banorëve sllavë. Në gjërat fetare janë të ftohtë, pothuajse indiferentë. Ata janë fanatikë vetëm atëherë kur është puna për paragjykime, për gjëra të jashtme dhe interesa materiale. Kthimi i shqiptarëve myslimanë në të krishterë do të jetë prandaj gjithnjë për çështje marrëveshjeje dhe të ndryshimit të kushteve politike të tyre, të cilat nuk do të lejojnë të vlerësohet më te ata islamizmi, si fe me influencë të privilegjuar e shtetit më të fuqishëm.

Kundërshtarët fetarë do t'i përkasin sigurisht në pjesën më të madhe popullsisë së qyteteve, e cila duhet të konsiderohet kryesisht nën influencën e klerit mysliman dhe autoriteteve turke.

Karakteristika të tjera kombëtare të shqiptarëve janë mikëpritja e tyre, mbajtja e shenjtë e fjalës së dhënë në grindjet me fiset dhe individët, qëndrueshmëria, zotësia e tyre morale dhe fizike dhe sedra e zhvilluar në lidhje me konceptet shumë të gjera mbi nderin. Nga ana tjetër ata janë kokëfortë, të paqëndrueshëm, lakmonjës dhe jo mirënjohës. Grabitjet dhe plaçkitjet janë më tepër pasoja të kushteve të mjerueshme, nën të cilat është detyruar të jetojë një pjesë e madhe e kombit. Hakmarrja është bërë e shenjtë me anë të traditës dhe të zakoneve, bile e rregulluar sipas normave krejtësisht të caktuara dhe që kanë hyrë në mish e në gjak të popullit. Siç e tregojnë shumë shembuj, shqiptari mund të heqë lehtësisht dorë nga grabitja dhe plaçkitja, për t'u bërë një bujk i qetë dhe punëtor, por jo edhe nga zakoni i

tmerreshëm i shpagimit të gjakut, i cili është i lidhur ngushtë me konceptin e tij të nderit dhe prandaj është jashtëzakonisht vështirë që të zhduket. Për më tepër është edhe gjendja e shumë pjesëve të vendit pa autoritet ligjor, sidomos e malësive, çka shtyn ata në vetmbrojtje dhe, sigurisht, janë dispozitat e pamëshirshme dhe të frikëshme të hakmarrjes, që pengojnë shumë keqbërje dhe krime. Sidoqoftë është një shenjë e mirë që populli e ka kuptuar gjendjen e mjerueshme të krijuar nga zakoni i hakmarrjes. Ai dëshiron ndryshim, por, në pamundësi që të shkëputet me anën e fuqive të veta, shpreson një kthesë që do të vinte nga krijimi ligjor i kushteve.

Pas këtij përshkrimi të shkurtër të karakterit të këtyre njerëzve, duke kaluar në gjendjen e kombit, duhet që, para të gjithave, të theksohet ndarja e tij në shqiptarë të veriut dhe të jugut, ose në gegë dhe në toskë. Kjo ndarje ka qenë shumë e theksuar në të gjitha kohët, edhe në ato më të lashtat. Të dyja pjesët e kombit qëndrojnë karshi; dialektet e folura në të dy anët ndryshojnë esencialisht shumë nga njëri - tjetri; cilësitë e këqia kombëtare janë sigurisht më të theksuara tek toskët. Gega është më i besuar, më kavalier dhe gjithashtu fizikisht është më i fortë. Tosku i krishterë është i besimit greko-oriental, gega i krishterë romako-katolik. Pastaj toskët kanë një degëzim të rëndësishëm në mbretërinë e Greqisë fqinje dhe prandaj anojnë më tepër për këtë strukturë shtetërore, ndërsa gega i krishterë, siç është vërtetuar me siguri, është i përfaqësuar përjashta vetëm në katër koloni, domethënë në Erico pranë Zarës, Peroi afër Polës, Ninkincë dhe Hertkovcë në Slavoni, të cilat e kanë ruajtur të gjitha kombësinë e tyre.

Kolonitë shqiptare të Napolit dhe të Siqelisë duhet të jenë krijuar më tepër me të ardhur nga pjesët jugore të Shqipërisë së Veriut dhe në pjesën më të madhe do të jenë përbërë nga emigrantët e Shqipërisë së Mesme. Mëmëdheu nuk di shumë për ta, pasi emigrimi i tyre daton qysh në shekullin XIV dhe XV. Për shkak të izolimit të plotë nga vendi i origjinës, ata duhen konsideruar të italianizuar, edhe pse i kanë ruajtur doket e zakonet e atdheut, si edhe, në pjesën më të madhe, gjuhën.

Ndryshe nga toska, i cili me përjashtime të pakta u islamizua dhe simbas natyrës anon më tepër nga Greqia, dhe në shumë vende është i përzierë me elementë helenikë, gega mbeti shumë më tepër besnik ndaj krishterimit, veçanërisht ndaj besimit katolik, me gjithë

konvertimet e shumta, që janë më tepër të kohës më të re. Ai me simpatinë e tij qëndron me Austro-Hungarinë.

Këto simpati shfaqen shumë më të plota ndërmjet katolikëve se ndërmjet myslimanëve, megjithëse nuk është vështirë të konstatohen edhe te këta. Karakteri i shqiptarëve, që me të drejtë akuzohen si jo mirënjohës, bën këtu një përjashtim nga rregulli. Gega katolik i është mirënjohës qeverisë perandorake dhe mbretërore për bamirësitë e shumta që merr prej saj, në lidhje me klerin, kishat dhe shkollat. Arsyja kryesorë është se në tërësi e ndjen veten deri në një farë pike nën mbrojtjen e shtetit perandorak dhe, së fundi, ai ka ditur të njohë dhe të vlerësojë në shumë raste efektin dobiprurës të kësaj mbrojtjeje, e cila është shfaqur shpesh herë në favor të klerit spiritual e pak, drejtpërdrejt, edhe në dobi të popullit.

Kufiri i lashtë natyror i Shqipërisë së Jugut me atë të Veriut është mbajtur edhe si kufi politik. Ai formohet prej lumit të Shkumbinit, i cili ndan provincat e Shkodrës dhe të Janinës, po ashtu siç ndante më përpara Genusaps Illyricum prej Epirit.

Kufiri i gjuhës ndërmjet toskëve dhe helenëve është vetëm në verilindje të Epirit dhe pikërisht prej Konicës dhe Desnikut në Pind deri në fushën e Gjirokastrës, prej këtu deri në detin Adriatik të dy elementët gërshetohen njëri me tjetrin. Por e sigurtë është se jugu i Epirit, domethënë Janina, Arta dhe Preveza, janë thjesht helenike, kurse Veriu domethënë Berati, Vlora, Tepelena dhe afërsisht gjysma e fushës së Gjirokastrës janë thjesht shqiptare (toskë), ndërsa perëndimi i vendit në mes, afërsisht prej rrethet të bregdetit verior të Prevezës deri në Himarë i përket elementit të përzier.

Vendi në qendër, domethënë pjesa e tokës nga Berati deri diçka në veri të Durrësit, duhet të shikohet si kalim nga jugu në veri. Në këtë pjesë dialekti toskë kalon gradualisht në atë gegë. Popullsija shqiptare e kësaj pjese të vendit është kryesisht myslimane, por përmban diçka si shumë koloni vllahë.

Kufiri i gjuhës shqipe-veriore dhe asaj sllave është, përndryshe, më i sigurt se ai i shqipes-jugore dhe helenike. Këtu kemi vetëm pak vende me gjuhë të përzier, madje në atë kuptim sa që përdorimi i të dy idiomave mund të lejojë që të njohësh mirë cila është shqipe dhe cila sllavishte. Përkundrazi, të dy elementët e popullsisë ndahen drejtpërdrejt e qartë njëri nga tjetri, përfshi edhe në ato pjesë të vendit

ku shqiptarët dhe sllavët banojnë të ngatërruar e ku secili lokalitet, sado i vogël, është menjëherë i dallueshëm sipas gjuhës, besimit dhe zakoneve. Në shumicën e lokaliteteve sllave të këtyre krahinave të përziera, shqipja në fund të fundit kuptohet dhe flitet. Kjo shpjegohet me faktin se shqiptari e shikon gjuhën e tij si sunduese dhe ja u lejon sllavëve mësimin e saj si mjet për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin.

Kufiri verior i gjuhës kalon nga perëndimi në lindje, në vazhdimësi, nga bregdeti Adriatik, pak nën Tivar, përmbi shpatet e maleve dhe këndin veriperëndimor të liqenit të Shkodrës, përpjetë nëpër Cem përmbi Fundinas, nëpër Kuç, në të dy lokalitetet, Vasojeviç dhe Kolashin, sadoqë atje shumica e banorëve flasin vetëm serbisht, por duken pjesërisht të origjinës shqiptare, çka vërtet paraqet shembull të një sllavizimi të shqiptarëve. Në gojëdhanat e fiseve të Shqipërisë së Sipërme flitet për dy vëllezër, Vasën dhe Grasën, Vasojeviqët, mbahen si bijtë e Vasës, kurse Grasniqët, të cilët janë thjesht shqiptarë, si bijtë e Grasës. Në bazë të kësaj gojëdhëne këto fise e shikojnë veten si të një gjaku, një rrethanë e cila në Cetinë është përdorur për të lidhur relacionet me Grasniqët.

Emri Kolashin duket se është emërtimi shqip i një fisi, që ka marrë emrin sipas të parit të vet, zotit Kolë Dshinit (ose Gjinit), pikërisht siç quhet Dukagjini një krahinë e dëgjuar, thjesht shqiptare, që fillon prej ku bashkohen Drinët dhe vijon gjatë Drinit të Bardhë deri lartë në Pejë.

Kufiri i gjuhës në vazhdimin e vet të mëtejshëm kalon prej Kolashini në Gusi dhe Plavë, përpjetë lumit Ibër në Rozhajë, pastaj prej Suhadoli dhe Glugoviku në Duga Poljana, mbi pllajën e Rogozmës, deri në perëndim dhe jugperëndim të Jenipazarit, ngjitet në krahinat e Vuçiternit, Kurshumlisë dhe Prokoplës, deri sipër në kufirin serb dhe pastaj kthen përsëri te lumi i Toplicës deri në derdhjen e tij në Moravën Bullgare. Prej këtu ajo vazhdon shumë a pak vijën e këtij lumi, si edhe të Moravicës që derdhet në të, deri në Kumanovë. Këtu vazhdon nga perëndimi përgjatë shpatit jugor të Karadakut nëpër kalimin e Lepencit, çan përmes fushën e Vardarit, afërsisht te hyrja e Treskës në Vardar, kalon pastaj gjatë Treskës, në Sanxhakun e Manastirit, vijon gjatë kufirit të tij me Dibren deri në pjesën veriore të liqenit të Ohrit dhe, prej këtu, kthen drejt perëndimit për në Shkumbin gjatë të cilit ajo kalon në jugperëndim dhe mbyllet duke arritur

përsëri në Detin Adriatik. Koloni shqiptare gjenden edhe përtej kufijve të treguar këtu, në Sanxhakun e Vidinit dhe Sofies. Përbrenda tyre ka shumë lokalitete të banuara prej shqiptarëve dhe sllavëve.

Bërthama kompakte e papërzier e racës së popullit shqiptar, pa marrë parasysh ndarjen e saj në një degë veriore dhe jugore, fillojnë prej kufirit jugor të shënuar më sipër, domethënë nga Konica, Gjirokastra dhe Himara, deri në vijën veriore të Liqenit të Shkodrës dhe, prej këtu, gjatë shpateve veriore të grumbullit të alpeve të lartë shqiptare, më në lindje deri te Drini i Bardhë, ku përfshin lokalitetet e Lumës dhe Tetovës, pastaj të gjithë territorin e Drinit të Zi, të Matit dhe të Shkumbinit në Elbasan. Që nga Drini i Bardhë deri në pllajat e larta të Dardanit, ndërmjet Prishtinës, Toplicës dhe Moravës, shqiptarët, megjithëse i kalojnë tepër numerikisht sllavët e vendosur këtu, prapëseprapë nuk paraqiten të papërzier dhe fillojnë përsëri të shfaqen bashkë në një masë të dendur në vendet e larta të përmendura më parë dhe në Karadak. Në përgjithësi, mund të vlejë si rregull, se në të gjithë lokalitetet e përziera shqiptarët kanë okupuar malësitë, ose të paktën vendet e ulëta afër grykave të maleve, duke u lënë serbëvet dhe bullgarëvet fushën. Përjashtim nga ky rregull gjejmë shpesh sidomos në lokalitetet malore të përziera, nga Kopaoniku deri në malet e Sharrit.

Përgatitja e një harte gjuhësore për të gjithë territorin e përshkruar këtu, është një problem i vështirë, që i tejkalon kufijtë e punës së tanishme. Me gjithë atë në fletët e bashkangjitura gjendet një paraqitje aproksimative e raportit të shqiptarëve me kombësitë fqinje dhe me elementët e këtyre të përziera me ta.

Për qëllimet e punës së parashtruar dhe për arsye të dukshme gjeografike dhe politike, shqiptarët epirotë të jugut vijnë shumë më pak në konsideratë se sa shqiptarët e veriut, prandaj këta mund të lihen pa u përmendur.

Shqiptarët e veriut që, në kuptimin më të gjerë, janë edhe banorët e Shqipërisë së Mesme, ndahen sipas strukturës së vargmaleve, që fillojnë nga Gusia dhe prekin bregun verior të liqenit të Ohrit në pjesën perëndimore dhe lindore. Grupin e perëndimit e përfshin pashallëku i Shkodrës, të lindjes ai i Prizrenit, Dibrës, Jenipazarit, Nishit dhe Shkupit, pra aproksimativisht qarku i ish vilajetit të Prizrenit. Ndërmjet tyre nuk ekzistojnë ndryshime gjuhësore ose të tjera, përveç disa nuancave fare të parëndësishme.

Të dhënat statistikore që pasojnë, të cilat janë përmbledhur sipas ndarjes së sotshme administrative, padyshim nuk mund të pretendojnë për një saktësi të plotë, por sidoqoftë ato janë aty afër me të vërtetën.

SHQIPËRIA (Veriu)*

Sanxhaku (Prefektura)	Kazatë (Nënprefekturat)	Myslimanë	Katolikë	Ortodoksë	Gjithsej
Shkodër	Shkodër	27.000	24.000	500	51.500
	Podgoricë	1.500	200	-	1.700
	Tivar	-	-	-	-
	Ulqin	8.400	4.000	-	12.400
	Zadrimë	2.500	7.800	-	10.300
	Lezhë	500	3.800	-	4.300
	Pukë	4.500	5.000	-	9.500
	Krajinë	5.100	1.600	-	6.700
	Anamal	3.000	1.800	-	4.800
	Kuç	100	1.700	-	1.800
	Krujë				
	Durrës	3.000	9.000		44.000
	Tiranë				
	Fiset	malore			
	Mirditë	-	18.500	-	18.500
	Hot	50	2.500	-	2.550
	Kastrat	50	2.000	-	2.050
	Kelment	100	3.500	-	3.600
	Shkrel	500	4.200	-	4.700
	Triepsh	-	600	-	600
	Rioll	1.800	1.400	-	3.200

* Në kuadër të Vilajeteve (u krijuan më 1864) janë shënuar vetëm sanxhaqet (prefekturat). Sipas statistikave të mësipërme Sanxhaku i Shkodrës kishte 199.750 banorë shqiptarë, nga të cilët 95.700 të besimit katolik, 104.150 të besimit mysliman dhe 500 të besimit ortodoks. Sanxhaku i Prizrenit kishte 199.200 banorë shqiptarë, nga të cilët 185.500 myslimanë dhe 13.700 katolikë. Sanxhaku i Prishtinës kishte 90.300 shqiptarë, nga të cilët 89.000 myslimanë dhe 1300 katolikë. Sanxhaku i Nishit kishte 58.000 banorë shqiptarë, të gjithë myslimanë. Sanxhaku i Shkupit kishte 31.000 banorë shqiptarë, të gjithë myslimanë. Sanxhaku i Dibrës kishte 190.000 banorë shqiptarë nga të cilët 188.500 myslimanë, 500 katolikë dhe 1500 ortodoksë. Sanxhaku i Jeni Pazarit ndërkohë kishte 30.000 shqiptarë, të gjithë myslimanë. Kështu numri total i shqiptarëve të llogaritur në Shqipërinë e Veriut shënohet 798.250 banorë, që sipas konsullit Lipih ishin 676.600 (84,76%) myslimanë, 119.650 (14,98%) katolikë dhe 2000 (0,25%) ortodoksë.

	Grudë	-	1.000	-	1.000
	Postribë	5.000	2.500	-	7.500
	Gjovanj (Shën Gjini)	-	500	-	500
	Plant	-	950	-	950
	Kir	-	600	-	600
	Sumë	-	400	-	400
	Toplanë	-	400	-	400
	Dushman	-	1.400	-	1.400
	Shalë	-	3.200	-	3.200
	Shosh	-	1.600	-	1.600
Prizren	Prizren	45.000	1.700	-	46.700
	Gjakovë+	25.500	9.800	-	35.300
	Pejë	20.000	2.200	-	22.200
	Gusinjë	5.000	-	-	5.000
	Kalkandelen (Tetovë)	55.000	-	-	55.000
	Lumë	35.000	-	-	35.000
Prishtinë	Prishtinë	21.000	-	-	21.000
	Gjilan	24.000	1.300	-	25.300
	Vuçitern	13.000	-	-	13.000

Veç 798.000 shqiptarëve të numëruar këtu në tërësinë e Shqipërisë së Veriut duhet të përfshihen edhe elementë të tjerë të popullsisë*. Në Sanxhakun e Shkodrës serbët, përkatësisht 2500 katolikë 21.800 ortodoksë dhe 11.300 myslimanë, janë shpërndarë në këtë mënyrë:

Sanxhaku i Shkodrës	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Katolikë serbë	Gjithsej
Shkodër	4.800	-		4800
Tivar-Krainë	4.300	4.500	2.500	11300
Podgoricë				
Kuç	12.700	7.000		19700
Gjithsejt	21.800	11.500	2.500	35800

Në Sanxhakun e Shkodrës ka dhe 5000 ortodoksë vllahë dhe pikërisht në kazatë e Durrësit dhe Tiranës, përveç afërsisht 3.000 jevgjëve myslimanë.

* Në sanxhakët e përmendur jetonin edhe 500.000 banorë sllavë. Nga këto 35.800 në Sanxhakun e Shkodrës, 79.000 në Sanxhakun e Prizrenit, 104.200 në Sanxhakun e Prishtinës, 78.500 në Sanxhakun e Nishit, 78.500 në Sanxhakun e Shkupit, 18.000 në Sanxhakun e Dibrës dhe 106.000 në Sanxhakun e Jenipazarit. Përveç sllavëve, në popullsinë joshqiptare bënin pjesë edhe 26.750 banorë nga grupe të tjera etnike, përkatësisht 7500 vllah, 3250 jevgj, 2000 hebrej dhe 14.000 çerkezë.

Sipas këtyre të dhënave popullsia e përgjithshme e Sanxhakut të Shkodrës përbëhet prej 243.450 frymë.

Në Sanxhakun e Prizrenit, kazatë përbajnë:

	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Ortodoksë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Muhamedan të përzier	Gjithsej
Prizren	15.500	15.000	-	-	2.000	32.500
Gjakovë	500	-	-	-	-	500
Pejë	15.000	-	-	-	-	15.000
Gusi	2.500	-	-	-	-	2500
Tetovë	-	-	26.000	2.500	-	28.500
	33.500	15.000	26.000	2.500	2.000	79.000

Në Sanxhakun e Prishtinës, kazatë përbajnë:

	Ortodoksë serbë	Katolikë serbë	Ortodoksë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë të përzier	Gjithsej
Prishtinë	11.500	-	-	-	-	11.500
Gjilan	20.500	1.200	-	-	-	21.700
Vranjë	-	-	60.500	-	-	60.500
Vuçitern	5.500	-	-	-	-	5.500
Mitrovicë	5.500	-	-	-	-	5.500
	42.500	1.200	60.500			104.200

Në Sanxhakun e Nishit, kazatë përbajnë:

	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Ortodoksë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë të përzier	Gjithsej
Nish	-	-	35.500	-	10.000	45.500
Leskoc	-	-	22.500	-		22.500
Prekuple	9.500	-	-	-		9500
Kurshumli	1.500	-	-	-		1500
	11.000	-	57.500	-	10.000	78.500

Në Sanxhakun e Shkupit, kazatë përbajnë:

	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Ortodoksë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë të përzier	Gjithsej
Shkup	-	-	30.000	3.000	14.500	47500
Kumanovë	-	-	29.000	2.000		31000
	-	-	59.000	5.000	14.500	78500

Në Sanxhakun e Dibrës, kazatë përmbajnë:

	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Ortodoksë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë të përzier	Gjithscj
Dibër	-	-	17.500	-	-	17.500
Dibër e poshtme	-	-	500	-	-	500
Elbasan	-	-	-	-	-	-
			18.000			18.000

Në Sanxhakun e Jenipazarit, kazatë përmbajnë:

	Ortodoksë serbë	Myslimanë serbë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë bullgarë	Myslimanë të përzier	Gjithsej
Jeni Pazar Beranë dhe të tjerat	80.000	26.000				106.000

Në sanxhaqet që u përmendën janë dhe 250 jevgj ortodoksë, 14.000 çerkesë myslimanë, 25.000 vllah ortodoksë dhe 2.000 izraelitë, kështuqë popullsia e përgjithshme e vendeve të banuara nga shqiptarët e veriut, duke llogaritur plotësisht dhe të sanxhakut të Jenipazarit, pastaj të rretheve Vranjë, Leskovc, Shkup dhe Kumanovë, mund të çmohet në 1.345. 150 frymë, nga të cilët 798.150 janë shqiptarë dhe 548.000 jo shqiptarë.

Nga elementët e kombësive të fundit, qoftë secili veçan, ose edhe në tërësinë e tyre, nuk arrihet forca numerike e elementit shqiptar, kurse përsa u përket cilësive ushtarake dhe politike ata janë shumë pas prej tyre.

Në qoftë se të gjithë territorin e trajtuar këtu, së bashku me popullsinë shqiptare energjike dhe të fortë, e mendojmë të vendosur në një tërësi administrative prej bregut Adriatik deri te Morava Bullgare, pra gati deri në mes të Gadishullit Ballkanik, si edhe shqyrtojmë veprimtarinë politiko-ushtarake që kanë mundësi të japin masat e bashkuara të popullit të Shqipërisë së Veriut, gjithshu dobitë strategjike që ekzistojnë, qoftë për një defensivë edhe për një ofensivë të fortë kundër Serbisë dhe Bullgarisë, atëherë do të jemi në gjendje të çmohim rëndësinë e veçantë që duhet të ketë zotërimi i atij territori për çdo fuqi që është e detyruar të mbrohet nga sllavizmi. Kjo vlen aq më

tepër për Austro-Hungarinë, e cila posedon nacionalitete sllave në veri e në jugë më tepër se sa duhet, madje me propabilitet të madh me depërtimin në Bosnje dhe Hercegovinë do të shtohen elementë të tjerë jugosllavë. Kështu një përforsim me nacionalitete jo sllave duhet të quhet i mirëpritur.

Shqiptarët e veriut të vetëm janë tepër të dobët që të mund të mbrohen në një ndeshje me sllavët. Por, duke qenë me një fuqi të madhe si Austro-Ungaria, ata mund t'i bëhen kësaj aleatë të vlefshëm, përdërisa ata janë jo vetëm një popull i fortë dhe me frymë krejtësisht antisllave, por edhe sepse okupojnë një territor, që, nga njëra anë, avancon deri në kufitë e principatës të Serbisë dhe, nga ana tjetër, deri në Moravën Bullgare, duke i vënë dukshëm fre lakmive serbo-bullgare për t'u zgjeruar. Në duartë e Austro-Hungarisë ky territor mund të merrte një pozitë, që do t'ua bënte të pamundur sllavëvet nën protektoratin rus, të tentojnë të marrin perëndimin e Gadishullit Ballkanik, aq shumë të dëshiruar, i cili është në sferën e interesave të monarkisë.

Antipatisë së shqiptarëve të veriut kundër sllavëve, këta i përgjigjen po me atë mënyrë. Kjo neveri reciproke e të dy racave shfaqet më tepër, natyrisht, në ato vende ku ata janë më tepër në kontakt me njëri-tjetrin, pra në pjesët e përziera të vendit, që nga Drini i Bardhë e deri tek Morava dhe që nga kufiri i Serbisë deri në Shkup. Në viset në fjalë shqiptarët i kanë prapsur gradualisht si serbët ashtu edhe bullgarët, duke përparuar në lindje që nga vendet e tyre, të ndodhur në perëndim të Drinit. Për serbët është sidomos i dhimbshëm okupimi i vendeve historike të Prizrenit dhe Prishtinës dhe në këtë mënyrë ata e kanë paguar shtrenjtë vënien e vendit nën zgjedhë në kohën e nemanjiqëve të fundit. Në këtë territor gjejmë pothuajse krejtësisht vetëm emra sllav të vendbanimeve, rrethanë e cila mund që të ketë kontribuar në përhapjen e opinionit se ato vise kanë qenë të banuara vetëm prej popullsisë sllave. Kur shqiptari zbrapste nga një pikë kolonizatorët sllavë, ai e mbante emërtimin e deriatëhershëm të vendit dhe e shumta e përshtaste atë për shqiptimin e tij, gjë që nuk mund të shënohej përmbi kartat.

Kolonive të reja ai u dha emra shqip krejt të rinj. Ky konstatim mund të vërehet edhe në Dibër, në vendet e Shqipërisë së Mesme, por edhe në vetë malësitë, ku emrat e vendeve paraqiten të ngatërruar

sllavisht dhe shqip, një dëshmi kjo, se këto vende i ishin nënshtruar sundimit serb ose bullgar dhe ishin pushtuar përsëri gradualisht prej shqiptarëve.

Popullsia shqiptare e territorit të përzier, të shënuar më sipër, e di mirë se deri sa të ekzistojnë serbët, këta nuk do të pushojnë kurrë së kërkuari vendet e lidhura ngushtë me traditat e tyre historike, sidomos, Pejën, qendrën e Patrikanës serbe të Prizrenit dhe Prishtinës, qendrën e dikurshme të mbretërve, si edhe fushën historike të Kosovës dhe praninë shqiptare atje do ta konsiderojnë si një pushtim. Të kërcënuar nga pretendimet serbe në çështjet e tyre jetësore, shqiptarët ruajnë këtu më me zell se kudo tjetër, çdo lëvizje sado të vogël të sllavëve për çlirim. Prandaj në fillim të luftës serbe të vitit të kaluar populli shqiptar i atyre viseve, u ngrit me nervozizëm të madh dhe formoi kontigjente të mëdha trupash jo të rregullta dhe i trajtoi në mënyrën më të pamëshirshme komunitetet sllave të kësaj ane, që sigurisht s'kishin faj që Serbia shpallte luftë.

Nuk ka dyshim se shumë nga ata shkuan pas lakmisë së grabitjes, por zelli i tyre ishte gjithsesi pasojë e qëllimit për të mbrojtur vendin kundër armikut kryesor, që ishte duke i invaduar dhe, njëherësh, edhe shfrytëzim rasti për të dobësuar elementin serb vendas.

Dihet tashmë se me ç'masa të gjëra u krye synimi i fundit. Menjëherë sapo ishin realizuar dy qëllimet kryesore të lëvizjes dhe disa qëllime të tjera praktike sekondare, si armatimi me armë zjarri moderne dhe me municione, kontigjentet vullnetare u kthyen përsëri në shtëpi, të gatshëm në çdo rast për të përsëritur skenat e djegjeve dhe të plaçkitjeve të vitit të kaluar.

Mbasi serbët e atjeshëm janë numerikisht më të pakët dhe të paisur me energji shumë më të dobëta, urrejtja e tyre shfaqet vetëm me kërcënime të pafuqishme dhe drejtohet ndaj të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, pra edhe kundër shqiptarëve katolikë.

Menjëherë pas deklarimit të luftës me rusët, nga ana e serbëve u hapën zëra në Prizren, që e vinin këtë urrejtje më në dukje. U fol se tani kishte ardhur më në fund koha e sllavëve dhe shqiptarët le të shikonin mirë se si, me ndihmën e vëllezërve rusë, do t'ua ndreqnin qefin, madje edhe fëmijët nëpër djepe nuk do të faleshin. Nuk ka dyshim se, në qoftë se do të vinte rasti i favorshëm, këto kërcënime

do të bëheshin realitet. Shqiptarët, duke e ditur mirë këtë, në çdo rast që situata shpërthen, veprojnë të parët duke i shkaktuar kundërshtarit dëmet më të pamendueshme, por vërehet se ata kujdesen më tepër për ta dobësuar moralisht dhe materialisht kundërshtarin se sa kërcënojnë vërtet jetën e tij, sadoqë, me brutalitetin që sundon, edhe vrasjet natyrisht nuk mund të përjashtohen. Kjo kujdesje relative nuk vjen aq tepër nga arsyet humane, për të cilat shqiptari nuk do të dijë, por prej konsideratës që raja sllave mos të dëmtohet pa qenë e nevojshme, mbasi është një komunitet shumë i mirë për të punuar e për të paguar taksa.

Në sajë të pozitës së vendit të tyre, dibranët bullgarë janë më pak të ekspozuar para rrezikut të serbizimit, se sa fqinjët e tyre matanë maleve të Sharit, të cilët dikur formonin pa dyshim shumicën dhe sot janë në numër të vogël. Këta tolerohen thjeshtësisht prej shqiptarëve, kohë pas kohe edhe keqpërdoren, gjë që së fundi u ndodh të gjithë bullgarëve, që janë fqinjë me dibranët, pra edhe komuniteteve bullgare të vendosura në Gostivar, Kërçovë, Strugë, Ohër etj.

Edhe në Dibër urrejtja për serbët është gjithashtu tepër e theksuar, vetëm se e lidhur me një nënvlerësim të madh, që ndoshta shpjegohet se këtu banon në grumbuj një fis i madh, jashtëzakonisht trim e kryelartë, ndonëse i egër e grabitqar, i cili e ka ruajtur më gjallë se gjetiu traditën e kohës së Skënderbeut. Ndërmjet familjeve të para të vendit nuk ekziston asnjë, që, në një mënyrë ose tjetër, nuk e lidh origjinën e saj me heroin kombëtar, prandaj çdo gjë që është antikom-bëtare, qoftë serbe, bullgare ose otomane, shikohet me përbuzje shumë të madhe.

Më në përfundim të vendeve që u përmendën këtu, pra në Shqipërinë e Sipërme dhe të Mesme, përkatësisht në territorin e Shkodrës, urrejtja për serbët ose frika, është më pak e konstatueshme. Përkundrazi urrejtja atje drejtohet kundër Malit të Zi, prapa të cilës më në fund ndihet një respekt i madh, dhe vështrimet janë drejtuar më shumë jashtë atdheut, sidomos në Austri dhe Itali. Cili nga të tre faktorët e përmendur do të ketë influencën më të madhe, kjo varet nga fakti se cili ndërmjet tyre do të ketë mundësi të verë më tepër në dukje këtë influencë. Në këtë drejtim Mali i Zi ka bërë shumë dhe aspiron akoma më tepër, por influenza e tij ngrihet ose ulet sipas suksesit të armëve të tij dhe, prandaj, nuk mund të flitet për relata simpatie. Ajo madje është e bazuar shumë në të holla, e shumta si

ajo para pak kohe në Mirditë, ndonëse është pikërisht paraja që rrjedh më pak në Cetinë. Influenca bazohet edhe në kontaktin e drejtpërdrejtë dhe në komunikacionin kufitar të gjallë me krahinat malore të veriut, gjë që është gjithnjë problematike dhe e përkohëshme .

Italia e ka mirë, se bregu Adriatik karshi është nën zotërimin e saj, se me limanet shqiptare ajo gjendet në raporte tregtare të shumëllojshme dhe këtu bën pjesë edhe Shkodra në sajë të Bunës, që është e lundrueshme. Limanet u ngjajnë diçka atyre të Dalmacisë, ndërsa mënyra e lidhjeve, që ka zënë mjaft mirë, bëhet njëlloj si dikur nën sundimin venecian dhe prandaj ato mënyra lidhjeje, ruajnë sot, deri në një farë pike, edhe traditat veneciane. Këtu, domethënë ndër limanet, influenza italiane e ka punën të lehtë, sidomos në Shkodër, popullsia katolike së cilës e dërgon rininë e saj me dashuri të madhe në Venedik për t'u edukuar. Këtë influencë e barazon vetëm Triesta tregtare dhe shoqërore, por edhe kjo, sigurisht, në një masë të tillë, që na jep të drejtën të themi se të dy influencat qëndrojnë në barazpeshë karshi njera tjetrës. Menjëherë porsa të dalësh nga qytetet limanorë, që së fundi janë vetëm Shkodra, Durrësi, Vlora dhe më së paku Leshi, dhe të shtrihesh në zonën fushore, gjithçka ndryshon në çast. Këtu zhduken menjëherë afrimet italiane dhe çdo gjë është e brumosur dhe e frymëzuar nga mendime thjesht kombëtare.

Popullsia katolike është krejt nën influencën e klerit të saj. Vetëm me përjashtime të pakta, e nga motivet fetare ajo është antiitaliane. Popullsia myslimane, në se është në gjendje që të formojë një ide mbi Italinë, ndjen frikë dhe përbuzje kundrejt saj dhe qëndron më parë në anën e Portës, me simpatitë e saj, mbasi një pjesë e rëndësishme e vendit, Shqipëria e Mesme, është gati krejt myslimane. Nuk ka dyshim, se sa më shumë të largohesh nga fusha bregdetare të futesh në brendësi të vendit aq më dukshëm pakësohet ajo simpati.

Në rrethet malore katolike nuk ekzistojnë aspak të tilla gjëra, por vetëm frika dhe antipatia. Myslimanët luftojnë çdo influencë të qeverisë dhe, njësoj si katolikët, ruajnë me zell institucionet e tyre të fisit. Provinca myslimane e madhe dhe me popullsi të dendur e Matit është kundërshtarë e vendosur e Portës. Bajraquet katolike kufitare, të Kthellës, Përlatit dhe Selitës, si edhe Mirdita fqinje dhe të pesë bajraquet katolike të Leshit, së bashku me popullsinë katolike të Zadrimës, janë në çdo rast gati që të shkëputen nga Porta. Por nuk

posedojnë udhëheqës si edhe pushkë me mbushje nga poshtë, dhe municion. Kjo vlen për të gjithë fiset malore të Shqipërisë, pa dallim feje, me përjashtim të atij të Gjakovës. Dukagjini kthehet andej ku shikon Mirditën të Fortë. Pulati është krejtësisht katolik dhe me mendime nacionale, por për shkak të pozicionit qëndron i mbyllur në vetvete. Fiset e malësisë së Mbishkodrës si të gjithë të përmendurit deri këtu, janë armiq të vendosur të qeverisë, por, mbasi nga njëra anë viset e tyre janë të kalueshme lehtë për veprime ushtarake dhe, nga ana tjetër, janë fqinjë kufitarë të Malit të Zi, u duhet që të manovrojnë andej këtej, ndërmjet këtij dhe Portës. Të gjithë këto fise malore, që përfaqësojnë bërthamën e forcës së popullit dhe që prandaj kanë një rëndësi të veçantë, qëndrojnë me simpatitë e tyre krejtësisht të vendosur në anën e Austro-Hungarisë, pse ata janë para të gjithave katolikë. Çdo udhëtar austriak, aq më tepër një konsull austriak, do të pritet këtu si vëlla dhe si mik. Këtu duhet vetëm një shtytje e vogël, për ta bërë influencën tonë të vetmen për të drejtuar, prandaj edhe kultivimi i saj është me rëndësi të madhe, aq më tepër se malet, me popullsinë e tyre të vendosur e sundojnë fushën dhe një ringjallje e vendit në kuptimin nacional, katolik dhe, në një pikë më të largët, austriak, duhet të fillojë dhe mund të fillojë në çdo kohë vetëm prej vendbanimeve të racës së Shqipërisë së Sipërme.

Përcaktimi i rrethit të simpative të shqiptarit të veriut për Austrinë, do të bëhet në mënyrë më të qartë, sikur të përfshihesh në të Shqipëria e vërtetë e veriut, në jug deri në Durrës, e deri brenda në Dibër dhe në lindje deri në Marovën bullgare. Këtu, nëpër malet, gjithashtu edhe mbi vendet fushore dhe pjesërisht në qytetet, si Shkodra, Prizreni, Gjakova e Dibra, emri i “Kralit të nemces”, i mbretit gjerman, është një fjalë magjike. Ky emër këtu përmbledh çuditërisht kuptimin e sundimitarit legjitim të lindur, të cilit i përkiste vendi në kohë e lashta. Me këtë mund të lidhen shumë mirë kujtime të mjergullta të luftërave të trupave perandorake dhe të pushtimit të përkohshëm të vendit prej Nishit dhe Jenipazarit deri poshtë në Shkup, si dhe gjurmë të mbetura në mendje nga periudha e shkurtër e perandorisë latine të Kostandinopolit. Por akoma më e çuditshme është se në rrethet ortodokse myslimane, veçanërisht ndërmjet dervishëve dhe hoxhallarëve, ekziston tradita e një afiniteti të ngushtë të “nemces”, nën të cilin mendohet akoma ekskluzivisht austriaku, me racën ariane, si dhe men-

dimi se kurora mbretërore e Persisë së vjetër e Nushirve, (apo kurora e Nushirvanit legjendar), ndodhet akoma në thesarin perandorak në Vjenë. Sipas kësaj shtëpia perandorake mund ta gjurmojë rënien e fisit të lartë të saj deri te mbretërit e vjetër pers dhe në rast se do të ishte fjala për lidhje të një kombi evropian me racat e lindjes, atëherë vetëm kombi i "nemces" duhet të konsiderohet si farefis i tillë.

Me përjashtim të traditave, ndjenjave ose mendimeve të disa klaseve të popullit, simpatitë shqiptare për Austro-Hungarinë mbështeten, veçanërisht, edhe mbi baza shumë reale. Katolikët kryesisht mbi besimin e përbashkët dhe mbi relacionin e protektorit, të cilën ata e gëzojnë, shumë ose pak, në mënyrë të drejtpërdrejtë në bazë të proteksionit të akorduar kultit prej qeverisë perandorake dhe mbretërore. Ajo e myslimanëve mbi antagonizmin Austro-Hungarez kundër tendencave të Rusisë për sllavizmin. Rusia, po të mos ishte e detyruar të merrte në konsideratë rrethanat, nuk do të hezitonte ta shtrinte influencën mbi të gjitha kombësitë e gadishullit të Ballkanit. Më tepër nga sa supozojmë zakonisht, shqiptarët muhamedanë kanë bindjen e plotë se Austro-Hungaria ka detyrën të prishë planet e Rusisë mbi vendet e Ballkanit sepse është e interesuar që të largojë nga vetja rrezikun sllav. Në këtë detyrë të sajën, ata shohin garancinë dhe rastin më të mirë për të mos rënë në duart e rusëve të frikshëm dhe të urreyer dhe kanë bindjen se Austro-Hungaria do të marrë përsipër rolin e mbrojtësit dhe të udhëhqësit të natyrshëm të tyre kundër Rusisë dhe sllavëve nën mbrojtjen e saj.

Natyrisht ata do të pëlqenin më mirë, sikur kjo të ndodhte në atë mënyrë, që Austro-Hungaria të delte thjesht si aleate e Portës së Lartë dhe autoriteti i sulltanit të shtrihej mbi provincat evropiane të perandorisë së tij. Në këtë relacion, shpresën më kryesore ata e kanë te Hungaria. Për aftësitë e saj të mbrojtjes dhe gadishmërinë për të ndihmuar Turqinë, ata kanë idetë më të larta. Ajo është për ta jashtëzakonisht simpatike. Në qoftë se kushtet do të ishin kundër një ndihme të tillë, ata do të viheshin patjetër në anën e trupave marshuese perandorake dhe mbretërore menjëherë sapo të thyhej rezistenca e Portës kundër armatave ruse dhe turqit nuk do të ishin më në gjendje që të shmangnin një invadim. Për çdo rast, për të siguruar bashkëpunimin e tyre, do të duhej të shtrohej më parë pyetja në se ata do të kishin shpresë se mund t'u rezistonin armëvet ruse dhe në se për këtë rezis-

tencë prisnin një ndihmë të madhe nga ana e Portës. Sidoqoftë kjo pyetje do t'u bëhej atyre vetëm nëqoftëse armata turke e Danubit do të bëhej e pazonja për rezistencë prej ndonjë sulmi total, ose prej një sërë fatkeqësish dhe do të ishte e detyruar të tërhiqej nga Ballkani, duke e dorëzuar vendin dhe duke e lënë pa mbrojtje përballë kolonave avanconjëse ruse.

Pasi asnjë shqiptar nuk do që të bjerë nën pushtimin e Rusisë dhe aq më pak të vihet në një gjendje të varur nga serbët dhe bullgarët e urryer dhe të përbuzur, kuptohet qartë përgjigja e vetme për pyetjen e shënuar.

Më në fund, një fakt i kryer do të krijonte një situatë e re. Ai do të ishte një marshim [i ynë] në Bosnje e në Hercegovinë, i cili do të pasohej me përparim në Bosnjen lindore, respektivisht në Senicë dhe Jenipazar dhe, pastaj, përtej këtyre pozicioneve, në fushën e Kosovës. Në këtë rast shqiptarëve do t'u mbetej të zgjedhnin ndërmjet Austrisë dhe Rusisë, çka do t'i çonte, më me efekt se nga gjithë mënyrat e tjera, te e para.

Një operacion i tillë, i filluar që nga Bosnja, do të ishte i këshillueshëm, përpara çdo gjëje tjetër, edhe nga arsyeja për të siguruar pozicionin e rëndësishëm të Nishit, të tokës së Kosovës dhe të luginës së Moravës, nga një përmbysje e papritur e situatës dhe nga një pushtim. Ajo do të prekte një herë vetëm pjesën lindore të Shqipërisë së Veriut dhe të Perëndimit, domethënë viset e Shkodrës, të cilat nuk mund të mendohen si të ndara krejtësisht nga e para, dhe të cilat do të mbeteshin, të paktën për momentin e parë, të hapura ndaj një pushtimi eventual italian. Prandaj pyetja është mos ndoshta do të ishte më me vend që, njëkohësisht me marshimin e trupave perandorake dhe mbretërore në Bosnjë dhe Hercegovinë, të pushtoheshin ushtarakisht edhe pikat më të rëndësishme të bregdetit shqiptar, Tivari, Ulqini ose Shëngjini, Durrësi, makar edhe Vlora dhe për këtë të merret parasysh bashkëpunimi i flotës perandorake dhe mbretërore. Në këtë mënyrë do të sigurohej Shqipëria e Veriut aq sa duhet dhe, për çdo eventualitet, do të përgatitej si bazë për pushtimin e Bosnjes e të Hercegovinës. Në një rast ekstrem, ndërmjet dy të këqijavet, Austro-Hungaria do të vepronte e do të zgjidhte marrjen për vete të Bosnjës e të Hercegovinës, ose themelimin e një perandorie jugosllave në kufirin jugëllindor të saj. Ajo do të pranojë riskun relativisht më të vogël, domethënë

pushtimin e përkohshëm dhe posedimin eventual të mëvonshëm të vendeve më të afërta. Prandaj do të bëhej shkak që ky fitim i imponuar nga rrethanat të paktën të vlerësohej në interesin më të mirë të saj, gjë që mund të bëhej mirë duke i zgjeruar mundësisht kufijtë e saj drejt lindjes ose jugut dhe, njëkohësisht, përreth tyre të ngrihej një mur mbrojtës kundër sllavëve kufitarë. Por Ilaçin me materialin më të mirë për këtë qëllim do ta formonin pikërisht shqiptarët e veriut, në qoftë se do të duhej që të përdreshin ata këtu për të lehtësuar krijimin e një postulati të nevojshëm për interesat shtetërore të Austro-Hungarisë, domethënë të paralizoheshin vështirësitë dhe rreziqet e elementit sllav, duke fituar një kombësi jo sllave, detyra tradicionale dhe e natyrshme e së cilës do të ishte që të kundërshtojë tendencat sllave.

Se ç'pozitë do të merrte Italia ndaj një pushtimi austro-hungarez të Shqipërisë, është një pyetje e cila nuk mund të lejojë që të përgjigjesh me supozime të thjeshta. Duket se është fakt, se në kohën e fundit politika italiane po i kushton Shqipërisë një vëmendje më tepër se të zakonshme dhe se organet konsullore të saja në Mirditë po zhvillojnë një veprimtari mbi çështje të rëndësishme. Natyrisht kjo ka çuar në kompromentimin krejtësisht të Italisë para syve të autoriteteve dhe të popullsisë, veçanërisht të mirditasve, duke i dhënë çështjes së tyre një goditje të ndieshme. Ka shumë mundësi që Italia të mos qëndrojë aspak indiferente kundrejt eventualitetit të shënuar më sipër, bile ajo ndoshta do të guxonte të hynte edhe në një konflikt luftarak me Austro-Hungarinë. Megjithëkëtë, është e dyshimtë në se ajo është e armatosur dhe mjaft e fortë për një gjë të tillë dhe në se do të ketë dhe fuqi të tjera me vehte për këtë gjë.

Për të ndjekur plane aneksimi në Gadishullin e Ballkanit, Italia nuk mund të mbështetet në asnjë fuqi tjetër, përveç se te Gjermania që është duke ecur në rrugën e një politike agresive ekspansioniste, pavarësisht nga realitetet e dobëta të kësaj të fundit ndaj Francës, së cilës nuk do t'i dukej aspak oportune ndjekja e një politike të tillë, aq më pak, në një kohë kur Rusia, siç na del rast pas rasti në shesh, është krejtësisht e angazhuar me Turqinë. Aleanca e tre perandorëve paraqet një garanci që, pikërisht së fundi me ndërmjetësinë ose garancinë e Gjermanisë, Austro-Hungaria të hynte në një diskutim dhe marrëveshje me kabinetin rus për të mbërritur në rrugën paqësore në

një rregullim të çështjeve të nxehta.

Italia nuk mundet dhe nuk duhet të guxojë që të hidhet në një konflikt, duke u mbështetur vetëm te vetja e saj, i cili për të do të kishte një përfundim tragjik. Nga ana tjetër një pushtim i Shqipërisë nuk do të ishte për Italinë një çështje e nevojës politike, siç është për Austro-Hungarinë, që kujdeset të krijojë atje një kundërpozicion ndaj shtimit të padëshirueshëm të elementit sllav. Italia tërhiqet atje thjesht nga kujtime historike, që nuk i përshtaten kohës së tanishme, si edhe prej tendencave të pushtimit. Më në fund më një pushtim të tillë Italia do t'i sillte vetes, me shumë propabilitet, vetëm probleme të rënda, sepse ajo nuk i kupton veçoritë e popullsisë fshatare [shqiptarë], veçoritë tradicionale, mënyrën e jetesës dhe doket e zakonet e tyre dhe kështu, që në fillim, do të krijonte antipati. Pastaj do të binte në konflikt me klerin katolik dhe ndërmjet tij me tërësinë e katolikëve dhe, më së fundi, do të ishte ndoshta e detyruar që ta trajtonte vendin si një tokë të pushtuar.

Si kompensim për heqjen dorë nga planet e saj shqiptare, që së fundi nuk janë vërtetuar, Italisë mund t'i ofrohej, në rast të një copëtimi të Perandorisë Osmane, një pozicion në bregdetin verior të Afrikës, p.sh. në Tripoli, një fitim, që për atë do të kishte një rëndësi të madhe detare dhe tregtare dhe që, ndoshta, do të aspirohej nga ajo më tepër se sa një pushtim i Shqipërisë.

Nga ana tjetër, Austro-Hungaria, nga pikëpamja e interesave të veta të menduara mirë, në asnjë mënyrë nuk mund të lejojë një pushtim të Shqipërisë së Veriut nga ana e Italisë, sepse në vend të një posedimi të kësaj province nga qeveria e Portës, krejtësisht e parrezikshme për të [Vjenën], që në asnjë mënyrë nuk i sjell dëme, aty do të zinin vend elemente turbullues, të cilët veprimtarinë e tyre të njohur do ta çonin jo vetëm në Dalmaci, por edhe në Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, bile do ta zgjeronin dhe më tutje përbrenda gjithë Shqipërisë, deri thellë në Rumeli, duke krijuar një situatë kundrejt së cilës kjo e sotmja, do të ishte më e preferueshme, sado e padëshirueshme që është.

Njëkohësisht edhe interesat tregtare të Austro-Hungarisë do të dëmtoheshin rëndë, do të shfaqej rreziku që vijat e mëdha të komunikacionit të monarkisë, që prej Mitrovicës nëpër Bosnjë dhe Serbi për në Selanik dhe Stamboll, do të binin në duart e një konkurenti politik

dhe tregtar nga parimet e të cilit mund të presësh çdo gjë.

Veçanërisht do të duhej bërë pyetja se ç'qëndrim do të mbanin Anglia dhe Franca ndaj një aksioni italian në lidhje me Shqipërinë. Në këtë rast do të supozohej me një farë siguriye, se këto fuqi do ta favorizonin një okupacion austriak, ose të paktën nuk do ta pengonin atë, përkundrazi një okupacion italian do ta shikonin me sy të shtrembër, në se nuk do të ishin të gatshëm për ta ndalur.

Tani del pyetja tjetër: Në rast se bëhet fjalë për pushtimin e Shqipërisë, Austro-Hungaria çfarë zgjerimi ka parasysh?

Nisur nga ajo që është e këshillueshme, se në qoftëse janë në plan pushtim të reja, nuk duhet të kënaqemi me pak, por mundësisht ta hedhim vështrimin larg, nuk do të ishte e rekomandueshme një pushtim i veçuar, ose i Shqipërisë lindore, ose i vendeve bregdetare perëndimore, domethënë secilës për llogari të saj.

Shqipëria perëndimore është relativisht një anë deti e ngushtë, të cilës nuk duhet lejuar t'i mungojë hinterlandi, ndryshe pushtimi i saj për Austrinë do të kishte vetëm rëndësinë e një Dalmacije të dytë. Gjithashtu Shqipëria e lindjes nuk mund të bëjë pa vendet bregdetare të Adriatikut, sepse, po të shkëputet nga kontakti me to, do të shtyhej drejt rrugëve politike dhe tregtare të tjera. Madje nuk do të ekzistonte asnjë arsye për ta copëtuar kombin [shqiptar], ndërkohë që më tepër do të kishte oportunitet që ai të mbahej në gjithë tërësinë e vet.

Të dyja pjesët e vendit kanë rëndësi politike, ushtarake dhe tregtare të barabartë për Austro-Hungarinë. Secila më vete dhe e izoluar nga tjetra, nuk do të kishte rëndësi në të njëjtën përmasë. Eksporti i prodhimevet vendase të Shqipërisë lindore, i cili në pjesën më të madhe ka marrë rrugën nëpër Selanik, po të lidhet kjo rrugë me bregdetin Adriatik me anën e një hekurudhe të degëzuar nga vija Selanik-Mitrovicë dhe stacioni i fundit i këtij degëzimi të vijonte me komunikacionin detar direkt me Triestën, atëherë do të kishte mundësi të drejtohej ekskluzivisht në këtë liman dhe, nga ana tjetër, do t'i jepte hov qarkullimit në të njëjtën rrugë të artikujve austriakë për të gjetur treg shitje në Shqipërinë Lindore. Via Triestes, nuk do të mund t'i delte përpara me sukses të rëndësishëm asnjë konkurrencë e huaj. Kështu do të mund të rifitohej përsëri pozicioni tregtar tani gati i humbur, madje do të zgjerohej edhe më tepër, sepse në vazhdimin e linjës Selanik-Mitrovicë për në Bosnjë dhe Nish të Serbisë, nga njera

anë dhe për në Sofie, nga ana tjetër, do të kishte mundësi që komunikacioni të zgjerohej në të gjitha drejtimet e Gadishullit Ballkanik. Në atë rast do të përdroreshin vijat austriake deri në zemër të këtyre vendeve, - një kombinacion ky tepër i dëshirueshëm, i cili nuk do të mund të ekzistonte në rast se të dy pjesët e vendit [të shqiptarëve], që i përkasin një të tërë, do të izoloheshin nga njëra-tjetra.

Për arsyet e sipërpërmendura një pushtim i Shqipërisë në Lindje do të rekomandohej të kryhej deri në Moravën bullgare, por bashkë me Nishin tregtarisht dhe strategjikisht njësoj të rëndësishme, deri në Ak-Palanka edhe në komunikacionin e kësaj pike kyçe, që ka gjithashtu një rëndësi të madhe, përmbi Shën Kollin (Sveti Nikollën) Ballkan. Caku jugor i kufirit të Moravës duhet të gjendet në Moravicë, shtrati i së cilës formon ndarjen e kufirit ndërmjet shqiptarëve të Karadakut dhe të bullgarëve të Kumanovës dhe Vranjës.

Lokalitetet shumë produktive të Leskovacit dhe të Vranjës, që bien në vijën e Moravës, për të mos u copëtuar nga kufiri i Moravës mund të mbahen edhe deri në shpatet e maleve, që përbëjnë kufijtë e përshtatshëm lindorë të sotshëm.

Duke ndjekur gjithnjë përhapjen e elementit shqiptar, kufiri i shpatit jugor gjatë Karadakut me përroin e Studenës mund të mbërrijë në Lepenc dhe prej këtu të bashkohet me kufirin e tashëm të Tetovës, në drejtim të Shkupit dhe të Kërçovës. Kështu brenda kufirit do të binte gryka e rëndësishme strategjike e Kaçanikut dhe hyrja prej jugut në veri do të lidhej përveç kësaj edhe me luginën e Moravicës. Kështu hyrja e vendit do të ishte krejtësisht në dorën e Austro-Hungarisë. Duke filluar nga kufiri i Tetovës dhe i Dibrës, kufiri i vendit do të ndiqte më mirë atë të sotmin, përmbi majat e maleve të Bistrës – Jamas [Mijacit?] - dhe Karçinit deri në malet e Debarcësi pastaj përtej kufijve të sotëm të Dibrës dhe të Ohrit, të vazhdonte gjatë rrjedhës së burimit të Shkumbinit, për të mbërritur te malet e Linës dhe prej këtu, duke bërë si kufi të jugut lumin Devoll dhe Seman, të zerë Adriatikut. Kufiri i Veriut, duke filluar nga deti në Nish do të jetë natyrisht ai që është sot, si ndaj Malit të Zi e Bosnjës Lindore, ashtu dhe ndaj principatës së Serbisë.

Një pushtim i [viseve të] epirotëve, edhe sikur ai të kishte në plan vetëm viset e toskëve të përzierë, do të ishte megjithatë ndoshta i lidhur me një zgjerim jorelativ të vijës bregdetare.

Por, me gjithë atë, do të ishte shumë i këshillueshëm pushtimi i rrethet shumë pjellore dhe produktive të Beratit dhe pozitës detare shumë të rëndësishme të Vlorës dhe të kripores së saj. Për më tepër Vlora është jashtëzakonisht e përshtatshme për ndërtimin e një hekurudhe përmes Thesalisë, dobisë e mëdha të së cilës janë theksuar nga shumë anë. Sigurisht, këto vise më mirë do të ishte të ndodheshin në duart austriake se sa në ato të të huajve, p.sh. të Italisë.

Me fitimin e Shqipërisë së Sipërme në shtrirjen e saj të plotë, natyrisht përveç shqiptarëve, në posedim të Austro-Hungarisë do të kalonin edhe afërsisht 400.000 serbë, bullgarë, jevgj e të tjerë, por këta përballë shqiptarëvet formojnë vetëm një minoritet, qoftë në tërësinë e tyre, qoftë secili më vete, ndaj do të jenë krejtësisht nën vëzhgimin e tyre.

Favorizimi në mënyrë të veçantë i minoritetit [jo shqiptar] nga një pozicion sllavofil, do të ndikonte brenda arsyes që shqiptarët të detyroheshin të emigronin dhe të viheshin në gjendjen e një majoriteti që sakrifkohet për hatër të disa minoriteteve të copëzuara, një padrejtësi kjo që edhe prej sllavofilit më të tërbuar me arsye, me të drejtë nuk mund të kërkohet.

Veç kësaj, elementi i përgjithshëm i Shqipërisë së Veriut ka një rëndësi të vërtetë politike vetëm në shtrirjen e shënuar dhe vetëm brenda kësaj paraqiten dobi për ekonominë kombëtare, dobi të cilat, për shembull me fitimin thjesht të territorit të Shkodrës, nuk do të realizoheshin dot, mbasi rrethet produktive, për rendimentet e larta të të cilëve jemi të sigurt, fillojnë pikërisht në atë anë të Drinit.

Në lidhje me sa më sipër, është veçanërisht për t'u shënuar lugina e Tetovës, Fusha e Kosovës, fusha e Moravës dhe ajo e Drinit të Bardhë, vise këto që qysh sot janë jashtëzakonisht produktive dhe për qeverinë e Portës të lidhura me dobi të mëdha financiare. Në lidhje me prodhimtarinë e burimevet natyrore të vendit, më lejoni përvujtësisht t'i referohem raportit tim politik-tregtar të këtij viti.

Çështja e krishterizimit eventual të shqiptarëvet myslimanë të veriut, në rast të një pushtimi të vendit nga Austro-Hungaria, duhet të kuptohet vetëm si konvertim i tyre në kishën katolike, se vetëm në një rrugë të tillë kombi do të mbetet i bashkuar edhe si besim, gjë e cila sigurisht do të ishte plotësisht e këshillueshme po të merret parasysh detyra që do t'i binte përsipër, [shqiptarëve], veçanërisht për t'u

kundërvënë sllavizimit ortodokso-grek, [detyrë e vështirë] në qoftë se ata copëtohen në një pjesë katolike dhe në një pjesë ortodokse. Shqiptarët myslimanë të veriut ruajnë akoma të gjallë në kujtesë konvertimin e tyre nga katolicizmi në islamizëm, shpesh dinë dhe epokën e saj, të cilën e tregojnë sipas brezave dhe kështu do të ktheheshin pa shtrëngesë në fenë e të parëve dhe të afërmeve të fisit të tyre.

Konvertimet i përkasin në një numër jo të vogël periudhave kohore të reja dhe shumë të reja. Kështu, për shembull, në mes të fiseve të kthyer në islamizëm disa familje dhe persona të krishterë akoma respektojnë detyrat fetare simbas ritit katolik. Në rrethinat e Prizrenit dhe të Gjilanit veç kësaj ka një numër katolikësh të fshehtë, të cilët po të paraqitet rasti do të pranenin menjëherë hapur katolicizmin. Të gjitha këto, si arsytet politike, ashtu dhe situata e vërtetë, do të çojnë në rikthimin e shqiptarëve myslimanë në katolicizëm dhe, në këtë rast, peshkopatave shqiptare, pjesa më e madhe e të cilave aktualisht kanë vetëm rëndësinë e famullive me një popullsi shumë të shpërndarë, do t'u jepet rasti të bëheshin pastaj pikërisht dioqeza të vërteta dhe të mermin misionin e madh, i cili do të kuptohej probablisht prej tyre në atë mënyrë që t'i përshtatet interesave të shtetit dhe të popullit. Më tej, kur ato të kenë plotësuar këtë, do të bëheshin edhe një faktor shumë i rëndësishëm për nxitjen e zhvillimit shoqëror dhe mendor të kombit.

Disa prej dioqezave për të cilat flitet natyrisht do të duhej që të riemëroheshin mbasi prelatët si emzot Pooten në Shkodër, Capaccio në Tivar, Ambrosio në Durrës, megjithëse janë burra shumë të respektueshëm dhe pjesërisht të ditur, për shkak të moshës së shkuar nuk janë më të aftë për veprime.

Emzot Bucciarelli në Prizren, Malczinski në Lesh, Giulio në Sapa dhe Gracchi në Pulat, janë burra më të rinj dhe inteligjentë, si të gjithë peshkopët shqiptarë-ultraromakë, janë edhe njerëz praktikë, të aftë për të kuptuar drejt situatën e ndryshuar të gjërave. Në sajë të njohurive të tyre mbi vendin dhe të influencës së tyre mbi popullin, këta janë në gjendje t'i bëjnë qeverisë punë të dobishme.

Kleri shqiptar gati në përgjithësi i është kushtuar meshtarisë. Vetëm disa misionarë franciskanë të kuvendit të Shkodrës kanë mësuar në shkollën elementare të atjeshme, kurse seminari i atjeshëm ndodhet në drejtimin e një prifti jezuit. Kleri tjetër është ekskluzivisht kler meshtarie, që ndahet në misionarë të urdhërit franceskan dhe në

kler shekullar. Këta të fundit janë pa përjashtim të kombësisë shqiptare.

Kleri i sotshëm, sidomos si kombëtar, nuk e kryen plotesisht misionin e tij, por sa për fillim duhet që të jemi të kënaqur, aq më tepër, sepse ai nuk mund të zëvendësohet nga që duhen marrë në konsideratë njohuritë e tij për gjuhën e vendit. Në rastin e konvertimit të myslimanëve natyrisht do të rezultonin kushte krejt të ndryshme, për të cilat kleri që është sot në dispozicion nuk do të mjaftojë dhe atëherë do të vinte momenti për të filluar edukimin e brezit të ri klerikal prej të cilit nuk do të kërkoheshin pretendime të mëdhaja, veç për shembull ato që i kërkohen tani klerit famullitar dalmatin.

Në rast të një pushtimi, aq më tepër të një posedimi definitiv të Shqipërisë së Veriut, do të duhej që autoritetet civile dhe ushtarake të kenë si detyrë që të përdorin një takt të madh, mbasi shqiptarët duhet të trajtohen me rigorozitet të madh, por edhe me konshiençë dhe me drejtësi, edhe pse qeverisen jo me lehtësi. Ata mund të bëhen të pabindur dhe të vështirë në rast se do të vihej dorë me forcë dhe para kohe në institucionet dhe zakonet e tyre kombëtare, edhe pse ato bazohen në paragjykime.

Të paktën duhet të kalojë një gjeneratë, para se të mund të mendohet për një ndryshim rrënjësor të gjendjes sotme, sepse, para të gjithave, duhet që popullsia të ngrëjë nivelin e ulët të sotëm kulturor, e cila do të arrihet vetëm me anë të edukimit të rinisë. Lëshimi i urdhëresave të rrepta kundër kusarisë, që ekziston në shumë pjesë të vendit, kundër dukurisë së hakmarrjes e, përgjithësisht, kundër veprimeve të paligjshme, mund të bëhet menjëherë dhe ato kanë për t'u pritur me mirënjohje. Përkundrazi, përsa i përket rekrutimit të trupave duhet që ky të mos bëhet për një kohë, për shkak të paragjykimeve që ekzistojnë në shumë vise për këtë. Të mësuar me një administrim të keq, të bazuar krejtësisht ose më tepër në shantazhe, arbitraritete dhe në partizanira të çdo lloji, brenda një kohe të shkurtër, kombi do të mësohet t'i kuptojë dhe t'i çmojë të mirat e një administrimi të rregullt, të bazuar mbi drejtësi ose ligj, kështu që me siguri mund të llogaritet bashkëpunimi i tyre kundër shfaqjeve të brutaliteteve dhe të mosnënshtrimeve.

Parimet e para themelore të një jetese qytetare paqësore, sigurimi i jetës dhe i pasurisë, janë dhurata të cilat shqiptari i njeh akoma pak. Për garantimin e tyre ai do të tregojë mirënjohës me vepra dhe,

me respektin e madh që ai ka ndaj autoriteteve të ndershme, do të sillej i bindur karshi tyre dhe do të bëhej një katundar dhe qytetar i qetë. Shqiptari zotëron një inteligjencë natyrale të plotë, e cila do ta ndihmojë të kuptojë shumë shpejt dobitë dhe mungesat e një pozite të re.

Në qoftë se kërkohet një njohje e zakoneve dhe dokeve shqiptare, para të gjithave vjen në konsideratë që të shqyrtohen ato të fiseve malore, të cilat me pak ndryshime kanë institucione kombëtare të barabarta, ndërsa zakonet dhe jeta e përgjithshme e popullsisë së qytetit dhe e fushës paraqet me pak karakteristika origjinale. Lejohem pra që punës së parashtruar t'i bashkoj një artikull të shkruar në vjeshtën e vitit të kaluar, i cili ka për objekt kushtetutën, (kannunin) zakonet dhe veçoritë e karakterit të mirditasve.

Konditat e parashtruara atje mund të adaptohen pak a shumë edhe për fiset e tjera malore të Shqipërisë së Sipërme dhe diskutimi i tyre bën pjesë në kuadrin e punës së parashtruar:

 Protokollin dhe Arkivi
 për korresp. politike i
 Ministris së jashtme p. dhe mb.

Shqipëria XX/I
 pa datë*

Mirdita

Mirdita përbëhet prej pesë bajraqeve, domethënë Oroshit, Xibrit, Fandit, Kushnenit dhe Spaçit. Sipas një regjistrimi të vitit 1858 këto bajraqe përmbanin 12.866 frymë në 1570 shtëpi. Në vitin 1868 popullsia përbëhej prej 15.880 në 1654 shtëpi. Në bazë të konditave të vëzhguara në fiset e tjera malore shqiptare shtesa e popullsisë është llogaritur me dy për qind në vit, pra për të pasë bajraquet e Mirditës rezulton sot [1876] një popullsi prej rumbullak 18.500 frymë.

Fandët e Gjakovës e të Pejës, emigrantë me origjinë nga fisi i Fandit, kompletohen vazhdimisht nga të gjithë pjesët e Mirditës dhe duhet që të numurohen së bashku, edhe pse jetojnë jashtë kufijve

* Artikulli për Mirditën është shkruar në vjeshtën e vitit 1876.

të pesë bajraqeve, përderisa ata gjithashtu janë në pozitën e këtyre të fundit që i përjashton vetëm në lidhje me shërbimin e luftës. Nga ana tjetër shërbimin ushtarak e bëjnë të veçuar.

Fandët me 4878 frymë në 542 shtëpira dhe me një popullsi të lëvizshme prej mesatarisht 1500 frymësh, që duhet të numërohen së bashku, mund të bëjnë që mirditasit, në këtë anë dhe në atë anë të Drinit, të çmohen rumbullak 24.000 frymë. Shënimet e treguara më poshtë paraqesin përmasat që ka Mirdita ndër fiset malore katolike të Shqipërisë së Sipërme.

Sipas Hahn-it, shënimet e të cilit, të bazuara në statistikat e famullive, edhe pse të datave të vjetra, janë prapëseprapë gjithmonë më të besuarat, fiset e peshkopatës së Shkodrës, domethënë Hoti, Kastriati Klementi, Shkreli, Triepshi, Riolli, Koçaj dhe Gruda, kishin në vitin 1868 në 2118 shtëpi 14.643 frymë, ata që i përkisnin peshkopatës së Sepës, pikërisht Dukagjini, në 1180 shtëpi kishin 8156 frymë. Simbas emzot Gracchi-t, ipeshkvit të Pulatit, fiset pulatase dhe bajraku Gjovan (?) me Sumën, Plantin, Kirin, Dushmanin, Toplanën, Shalën, Shoshin, Nikajn dhe Merturin, në vitin 1872, në 1512 shtëpia kishin 12.320 frymë.

Popullsia malore e besimit katolik e Shqipërisë së Sipërme do të kapte kështu, duke përfshirë mirditasit, fandët dhe të tjerët, që janë pjesa më e madhe të fisit Berishë, të instaluarit në rrethet e Gjakovës dhe të Pejës (1200 frymë në 133 shtëpira), llogaritur me shtesën dy për qind për çdo vit, rumbullak 65.000 frymë.

Fiset dhe bajraquet e japin numrin e personave të aftë për armë aty afër sa gjysma e popullsisë së saj mashkullore. Po të llogaritet po kjo shumë, por me një të tretën, një proporcion, që nuk përbën asgjë të tepruar, duke konsideruar të aftë për armë moshën nga 15 deri në 60 vjeç, - do të kishim:

Për Pulatin rumbullak	2.000 luftëtarë
Për Mirditën	3.000 luftëtarë
Për Fandët	800 luftëtarë
Për "Berishajt"	200 luftëtarë
Për fiset malore të Shkodrës	2.800 luftëtarë
Për Dukagjinin	1.570 luftëtarë

10.370 luftëtarë, numër i cili mund të ngrihet deri në 12.000

Duke llogaritur numrin e popullsisë katolike në peshkopatat e Tivarit, Shkodrës, Sepës dhe Leshit të peshkopatës së Durrësit, çmuar me rrumbullak 50.000, të Shkupit (Prizrenit) në rrumbullak 5.000, duke përjashtuar fandët dhe berishët do të na rezultonte se në Shqipëri (të Sipërme e të Mesme) ka një popullsi të përgjithshme katolike prej 120.000 frymësh. Kjo, duke zbritur popullsinë e Shkodrës, është në gjendje të japë një shifër të rrumbullakosur prej 18.000 burrash luftëtarë.

Të kthehemi përsëri te Mirdita. Deri në nënshtimin e rebelit Mustafa Pashës, sundimtarit trashëgimtar të fundit të Shkodrës nga fisi i Bushatllinjve, Mirdita ndodhej administrativisht nën pashain e Pejës, e në kuptimin më të gjerë, sundimtarin e Dukagjinit. Por për shkak të pozitës gjeografike të vendit të tyre të vogël, mirditasit ranë gjithnjë e më shumë nën varësinë efektive të pashait të Shkodrës. Armiqësitë e saj të paprera me Pejën dhe me fiset e tjera sunduese të Shqipërisë, para së gjithash të Malit të Zi, i dhanë asaj të kuptojë, se duhet të fitonte miqësinë e fiseve të atyre viseve që u përkisnin rivalëve, por që binin në rrethin e sferës të influencës së saj dhe kështu u formuan lidhjet e mirditasve më gjerë.

Mbasi në vitin 1831, kur pas mundjes së Mustafait, Reshit Pasha vendosi të parin guvernor në Shkodër, të emëruar nga Porta, Mirdita çfaqti kërkesën, që t'i përkiste definitivisht këtij pashallëku, kërkesë e cila u pranua duke i vërtetuar edhe privilegjet e saj të trashëguara.

Këto privilegje ekzistonin qysh në kohët e vjetra dhe ekzistojnë edhe sot akoma në autonominë e plotë, kundrejt detyrimit për të dhënë ushtarë dhe një haraç të përvjetshëm. Detyrimin e parë, Mirdita ishte dhe është e detyruar ta plotësojë, por jo për më tepër se gjashtë muaj në një vit dhe vetëm në shërbim të vetë sulltanit të madh e nën flamurin e vet. Në fushatat luftarake në vise të largëta ajo duhet të japë 400 burra, të cilët marrin nga qeveria racionin në bukë e në djathë dhe një pagë të vogël, që paguhet njëherësh. Në fushatën kundër Malit të Zi forca e kontigjenteve të saj varet gjithmonë nga prirja, e saj e madhe ose e vogël, për t'iu pëgjigjur thirrjes, por ajo nuk i kalon kurrë të 1.000 vetët.

Pozita e Mirditës, që i përngjan asaj të një vasali, bazohet në principin e organizimit të fisit dhe të kantonit, i cili është i përbashkët për të gjithë malet e Shqipërisë së Sipërme, pa dallim fetar, me

një administrim autonom shumë a pak të zhvilluar dhe me administratë drejtësie. Kjo e fundit është e zhvilluar nga kanuni i vjetër i Dukagjinit, gjithashtu i përbashkët për gjithë fiset dhe rrjedh nga normat e pashkruara të Lek Dukagjinit për malësitë, të cilat trashëgohen dhe respektohen brez pas brezi.

Sundimtarët osmanë të Shqipërisë, që më të shumtën e rasteve rrjedhin nga fiset e vendit, e pranojnë autonominë e Mirditës dhe të fiseve të tjera të malësive, deri sa ajo ka si bazë kanunin e vjetër të fisit dhe kushdo që kishte guxuar të lëkundte liritë shqiptare në këtë shtyllë bazë, menjëherë kishte krijuar kundër vetes një koalicion të gjithë malësive, si katolike ashtu edhe myslimane, një rrezik ky aq i madh dhe eminent, sa që kushdo ja lëshonte rrugën me qejf. Porta nuk mundte dhe as që donte të ndryshonte këtë situatë, sepse deri në kohën më të fundit ajo ishte e pafuqishme dhe që ta themi drejt, ajo karshi malësive është akoma edhe sot e pafuqishme. Një kryengritje e përgjithshme e malësive shqiptare do të ishte një shuplakë shumë e rëndë për Portën.

Por, gjithsesi nuk duhet thënë se mirditasit, gjithashtu dhe fiset e tjera, nuk kanë qenë të detyruar të përulëshin shpesh para forcës së pashait të Shkodrës dhe të Pejës, ose të vetë Portës. Ata e kanë provuar prej tyre dorën e rëndë dhe më tepër se një herë kanë qenë shkretuar dhe pushtuar. Por mbas këtyre ndëshkimeve punët ktheheshin gjithnjë përsëri në gjendjen e vjetër.

Prandaj nëqoftëse mirditasit lavdërohen se tokat e tyre nuk qenkan shkelur kurrë prej një ushtarit turk, kjo është relativisht e drejtë, deri sa Porta kishte marrë direkt në dorë administrimin e Shqipërisë dhe kishte njohur privilegjet e fiseve dhe në përgjithësi nuk interesojë shumë për gjendjen e tyre të brendshme. Kjo ishte edhe sistem, por ishte edhe pasojë e një farë frike të kuptueshme për të mos i ndezur tepër me masa shtypëse ato fise turbulluese, të cilat ia kërkonte arsyeja dhe oportuniteti t'i trajtonte më butë për shkak të afërsisë me Malin e Zi. Restin e bënte plogështia e guvernatorëve. Por nuk kanë munguar edhe shembuj ndëshkimi të zbatuara kundrejt një fisi prej trupave të Portës.

Përsa i përket veçanërisht Mirditës, ajo nuk ka bërë kurrë një kryengritje të hapur kundër autoritetit të Portës dhe detyrën e ngarkuar për shërbim ushtarak e ka kryer shumë a pak gjithnjë plotësisht, ndaj

edhe nuk ekzistonte asnjë arsye e veçantë për një ndërhyrje të armatosur. Pastaj një gjë të tillë nuk ishte nevoja që të zbatohet ndaj Mirditës sepse prodhimtaria e saj është aq e pamjaftueshme, sa që brenda një kohe të shkurtër mund të bëjë që mirditasit të vdesin nga urija menjëherë sapa të pushtohen ushtarakisht rrugët e komunikimit, që të çojnë në brendësinë e saj. Këto të fundit janë të tilla, që një ushtri e rregullt nuk i ka problem

* * *

Relacion i konsullit Lipih i 17 marsit 1877 për Ministrin në Vjenë dhe të ngarkuarin me punë të Austro-Hungarisë në Stamboll*

Prizren, më 17 mars 1877

Me urdhëresën nr. 275, më 2 të këtij muaji, zoti i ngarkuar me punë, [në Stamboll] baroni Herbert, më ftoi, për t'i shfaqur mendimin tim mbi krijimin e provincës së Kosovës.

Mbasi i raportova mbi këtë gjë më 5 të këtij muaji [me shkresën] nr.4, në përputhje me ftesën që më erdhi, marr leje sot për ta trajtuar më hollësisht të njejtin objekt.

Për të dhënë një gjykim të gjithanshëm mbi vleftën reale të masës në fjalë, [të ndërmarrë nga Porta e Lartë] duhet të merren parasysh pikësynimet e saj të dukshme. Për këtë pikëmbështetjen më të afërt e jep përbërja e provincës së re sipas raportit numerik të kombësive dhe konfesioneve [fetare] që përfaqësohen në të.

Sikurse njoftova, ajo përbëhet nga mytesarifllëqet [sanxhaqet] e deritashëm të Prizrenit, Jenipazarit, Nishit, Shkupit dhe Pirotit. Duke marrë parasysh se selia e qeverisë provinciale u transferua në qendrën e rrethit, në Prishtinë mbasi valitë përveç funksionit si të tillë, kryejnë edhe funksionet e mytesarifëve të mëparshëm të sanxhaqeve, që varen prej kryeqytetit të provincës, u desh të krijohet ky sanxhak i ri dhe për këtë qëllim u shkëputën rrethet e Prishtinës, Gjilanit dhe Vuçiternit nga Prizreni, ai i Mitrovicës nga Jenipazari dhe ai i Vranjës nga Nishi dhe u bashkuan me të. Pra provinca përbahet nga sanxhaku i

* AIH, Vj. 29-16, nr.9. Relacion i Lipih (Prizren 17 mars 1877).

Prishtinës në rrethet e përmendura, nga ai i Prizrenit në rrethet Prizren, Tetovë, Lumë, Gjakovë, Pejë dhe Guci, nga ai i Jenipazarit me rrethet Sjenicë, Jenipazar, Tërgovishtë, Biopolje (Akova), Priepolje, Novivarosh, Plevlje (Tashlixhe), Beranë dhe Kolashin, nga ai i Nishit me rrethet Nish, Leskovac, Prokuplje dhe Kurshumli, nga ai i Shkupit me rrethet Shkup, Kumanovë, Palankë, Karatavë, Koçanë, Radovic dhe Ishtip, nga ai i Pirotit me rrethet Pirot dhe Tërn (Isnebel).

Bashkëngjitur po iu dërgoj një tabelë statistikore të popullsisë së provincës me shifra pothuaj ekzakte. Nga ajo del se bullgarët e krishterë dhe shqiptarët myslimanë formojnë grupe popullsish pothuaj njësoj të forta dhe se të krishterët janë pak më shumë. Pas shqiptarëve dhe bullgarëve vijnë serbët e krishterë si elementi etnik i dytë nga numri, pas këtyre vijnë myslimanët e racës së përzier, d.m.th. jerekët, tatarët dhe turqit, pastaj serbët dhe bullgarët myslimanë, shqiptarët katolikë, çerkezët, jevgjit, disa serbë katolikë, vllahët ortodoksë dhe izraelitët, në përgjithësi një tabelë model e shumicës së racave dhe konfesioneve që përfaqësohen në Turqinë evropiane. Proporcioni në dukje i favorshëm midis të krishterëve dhe myslimanëve zhduket përsëri dhe bëhet i disfavorshëm për të parët prej rrethanave të ndryshme. Njëra nga këto është se serbët e krishterë, duke qenë të shpërndarë midis vëllezërve të tyre fanatikë [myslimanë] të fisit dhe arnautëve, në pikëpamje politike duhen konsideruar si një faktor i parëndësishëm. Të përkulur nga shtypja e gjatë, ata i kanë ende të freskëta vuajtjet e vitit të kaluar. Goditjet ekonomike që morën e zhdukën begatinë e tyre të mëparshme relativisht të madhe dhe, nga një ditë në tjetrën, ata janë në rrezik të pësojnë ndjekje të reja dhe të humbin pasurinë dhe jetën.

Elementi bullgar i krishterë vitin e kaluar, por edhe tani, vuajti dhe vuan pothuaj njësoj. Vetëm pak rrethe të Shkupit dhe Pirotit shpëtuuan relativisht më mirë se të tjerat.

Bullgarët vetëm nga numri vijnë pothuaj baraz me elementin etnik më të fortë, me elementin mysliman shqiptar, madje bashkë me serbët dhe shqiptarët katolikë e kalojnë pak atë dhe myslimanët e tjerë. Por njëherësh ndaj shqiptarëve katolikë dhe ortodoksë ekzistojnë antipati të thella nacionale dhe konfesionale, pastaj dhe bullgarët dhe serbët nuk janë gjithmonë miq, ndërsa myslimanët, kur është fjala për të shtypur aspiratat kristiane dhe sa herë është puna të nxjerrë

nga të krishterët me dredhi ose dhunë përfitime materiale, bashkohen gjithmonë kokë më kokë, ndonëse midis arnautëve dhe myslimanëve jo shqiptarë ekziston pak dashuri.

Duhet shtuar se të gjithë myslimanët e provincës janë të armatosur shumë mirë, janë paisur më shumë se me bollëk me pushkë të sistemeve më të reja dhe me municion, kurse të krishterët, me përjashtim vetëm të shqiptarëve katolikë të Gjakovës dhe të Pejës, nuk kanë armë dhe nuk kanë edhe pririje ushtarake të veçanta. Këtu ndoshta mund të bënin një përjashtim vetëm bullgarët e gjallë të Pirotit. Të gjithë të tjerët, dhe në radhë të parë bullgarët e Shkupit, janë një racë moralisht shumë e degjeneruar.

Megjithatë të krishterët, në rrethanat që atyre do tu siguronin një trajtim sipas parimeve të njëjta ligjore, brenda një kohe të shkurtër mund të ngriheshin shumë moralisht dhe materialisht në krahasim me myslimanët dhe mund t'i kalonin ata. Por ka vetëm pak shpresë që të lindin rrethana të tilla, sepse, edhe në qoftë se politika e Portës nuk do të përpiquej që elementëve myslimanë t'u ruante kudo përparësinë mbi elementët e krishterë, qeveria provinciale, edhe sikur të kishte qëllimin më serioz dhe aftësinë për t'i shfrytëzuar për të mirën e të krishterëve liritë e proklamuar konstitucionale, përballë shqiptarëve ajo përsëri do të vepronte shumë ngadalë. Ajo nuk do të guxonte t'i kundërvihet këtij elementi etnik të mbushur me urrejtje kundër rajave sllavë, për shkak të numrit të madh dhe forcës, duke preferuar ose vetëm duke u dhanë të drejta të barabarta sllavëve. Kjo do të jepte shkak për pakënaqësi, që për autoritetet osmane është me rrezik në konstelacionin e tanishëm, kur nga dita në ditë mund të jenë të detyruara që madje të kërkojnë përsëri ndihmën e shqiptarëve. Edhe në rrethana të zakonshme energjia dhe durimi që karakterizojnë racën shqiptare, si edhe zotësia e saj për të dominuar çdo nacionalitet të huaj që hyn në rajonin e saj, i ka prapsur kudo fqinjët sllavë. Prandaj ajo, aq më me zell do ta kryente tani detyrën që i përket prej natyre dhe që Porta sigurisht i ka rezervuar asaj, për të mbajtur të qetë sllavët që gjenden atje. Por në qoftë se qeveria provinciale heshtur është sadopak dakord dhe kjo nuk do të mungojë dhe nuk mund të mungojë, presioni shqiptar do të shtohet në atë masë, sa që gjendja juridike dhe sigurimi i të krishterëve a priori do të baheshin shumë problematikë. Qeveria me zaptiet e rekrutuara në radhë të parë nga arnautët, në çdo kohë ka

në dorë një armë të sprovuar kundër popullsisë kristiane, por në rast trazirash ajo, sikundër tregoi viti i kaluar, mund të mbështetet me siguri mbi të gjithë masën e arnautëve, për të cilët vërtet nuk janë në pyetje dhe aq motivet fetare se sa egoistike, mbasi pasioni i tyre për të plaçkitur nga njëra anë dhe antipatia kundër çdo gjëje sllave, nga ana tjetër, morën përsëri ushqim të ri me bollëk nga fushata serbe.

Çdo tentativë e sllavëve të krishterë me t'u çuar kundër shtypjes së dyfishtë të qeverisë dhe të islamizmit që e mbështet atë, ose për t'u bashkuar me një lëvizje të jashtme, do të kishte për ta konsekuencat më të tmerrshme dhe, mbasi e dijnë mirë këtë, ata më mirë durojnë ndjekjet e çdo lloji se sa mizoritë, që mund të pasojnë, në krahasim me të cilat ato të vitit të kaluar do të ishin ndoshta të parëndësishme.

Në rast se eventualisht shpërthen lufta ruso-turke, të krishterët vetvetiu janë shumë në rrezik, gjë që, siç besoj, nuk do të ndodhte po qe se hynin trupat e një shteti tjetër, sepse shqiptarët në radhë të parë nuk duan të sllavizohen, ose, çka për ata është njësoj, nuk duan të majorizohen prej masave popullore sllave të privilegjuara. Ata kanë frikë pikërisht nga Rusia dhe jo prej fuqive të tjera. Po të mendojmë tani se shqiptarët e provincës, në qoftë se bëhet një mobilizim i përgjithshëm, mund të japin lehtësisht 40.000 vetë dhe myslimanët e tjerë 10.000 vetë, këto trupa, edhe pa ndihmën e një force ushtarake të rregullt, mjaftojnë plotësisht për të mbytur me një herë në embrion çdo tentativë kryengritjeje bullgaro-serbe në provincë. Kuptohet pra përse pikërisht me këtë vilajet të ri u bashkuan krahina të mëdha bullgare të rajonit.

Prandaj në qoftë se ndonjë herë përhapet mendimi dhe ai u shpreh në disa gazeta, se krijimi i provincës së Kosovës duhet konsideruar si një koncesion në interes të bulgarëve dhe të krishterëve, kushdo që e njuh pak gjendjen, duhet t'i mohojë atij çdo bazë.

Përkundrazi Porta e Lartë e dobësoi pozitën e të gjithë kombit bullgar, duke shkëputur nga trungu i tij në Danub dhe në Ballkan një pjesë të mirë dhe themeloi vetëm me një pjesë të tij Sanxhakun e Pirotit për t'i dhënë hapit që ndërmori një dukje liberale, por, njëkohësisht, e vendosi elementin bullgar në një raport të llogaritur mirë të bashkimit administrativ, me elementin shqiptar, gjë që padyshim i përgjigjet shumë mirë interesit të saj. Veprimi i ndërmarrë mund të

jetë gjithçka tjetër, veçse jo një koncesion. Nuk dua të them me këtë se Mithat Pasha, krijuesi i provincës së Kosovës, synonte me themelimin dhe përbërjen reale të saj, t'i krijonte iluzione popullsisë së saj kristiane për të drejtën konstitucionale të premtuar, duke i vënë asaj pranë të njejtin numër shqiptarësh, armiq të reformave. Gjithsesi, në qoftë se marrim parasysh gjendjen e këtushme kulturore dhe antipatitë nacionale, si edhe përfaqësimin numerik dhe kualitativ që popullsia kristiane ka në këshillat administrative dhe juridike të provincës, edhe kjo ide është afër mendjes. Padyshim është treguar kujdes që me gjithë fushën e lojës që i lihet asaj popullsie brenda kuadrit të kompetencave të saj konstitucionale, ajo politikisht të jetë e paralizuar.

Relativisht më lirshëm se të gjithë do të mund të lëvizin bullgarët e Pirotit nën nxitjen e miqve të tyre të krishterë dhe do të ishin të mbrojtur para uzurpimeve myslimane-shqiptare, por ata përmbajnë vetëm një pjesë të vogël të elementit të përgjithshëm sllavo-kristian. Për këtë arsye ky element në krahinat e tjera të rajonit është në një pozitë edhe më të keqe dhe, deri sa parimet liberale të gjenin të administrata shtetërore e Mithat Pashës një garanci më të madhe, kish premisë ta përmirësonte gjendjen e tij të deritanishme të vajtueshme, vetëm në se organet qeveritare do t'i zbatonin me integritet dhe pa rezerva idetë e Mithat Pashës.

Sikurse janë punët sot, elementi i krishterë do të ishte i lumtur që myslimanët, bile arnautët, të cilët përbëjnë morinë e personave qeveritarë dhe rrinë së bashku me të krishterët në këshillat administrative, të jepnin mundësinë, që në kuadër të këtyre këshillave të bëhej e mundur edhe tani si më përpara, pjesëmarrja në punët qeveritare. Kjo do t'i përgjigjej uzus-it të deritanishëm; natyrisht pa e përmirësuar në gjendjen e klasave popullore kristiane, përveç atje ku nga rrethanat janë krijuar kushte paraprake më të favorshme. Por ato këtu janë aq të disfavourshme sa s'ta merr mendja.

Prandaj, edhe në këtë drejtim, krijimi i provincës së Kosovës nuk mund të pretendohet që të përshëndetet si një zgjidhje që i përgjigjet kërkesave të një përmirësimi, sikundër e kërkon koha*.

Ndarja nuk është vetëm gjeografike. Ajo bazohet edhe mbi karakteristika të tjera që dallohen lehtë, madje edhe gjuhësore, të cilat

* Dokumenti ka një faqe shkëputje.

ndoshta e kanë rrënjën në faktin se bullgarët e sotëm të perëndimit u përhapën shumë larg përtej kufijve të natyrshëm të trevës së tyre dhe kështu nuk e ruajtën dhe aq të pastër karakteristikën e fisit, krahasuar me vëllezërit e tyre në lindje. Për t'i dalluar prej bullgarëve të Ballkanit Danubian, ata mund t'i quajmë edhe bullgarë maqedonas, sepse shtrihen mbi të gjithë territorin e Maqedonisë së vjetër. Nën qeverinë e Portës ata veç kësaj, siç dihet, administrativisht gjithnjë kanë qenë të ndarë prej bullgarëve të Evropës danubiane dhe të Trakisë. Bullgarët e Kosovës, d.m.th. ata që u bashkuan me provincën e re, i përkisnin pjesërisht gjysmës lindore të fisit dhe pikërisht janë bullgarët e Nishit, Pirotit dhe Vranjës dhe pjesërisht gjysmës perëndimore. Te këta të fundit hyjnë bullgarët e Tetovës dhe të Shkupit. Ata bashkë me bullgarët e tjerë të perëndimit, që janë vendosur në rajonin e vilajetit të Selanikut, kanë të njëjtat karakteristika tipike dhe gjenden, sikundër edhe ata të lindjes, nën autoritetin e ekzarkatit, atij institucioni, i cili është destinuar që të unifikojë gjithë kombin dhe të realizojë nën maskën e autonomisë fetare, autonominë e tyre politike në kuptimin e një Bullgarie të madhe.

Çështja e mënjanuar përkohësisht e pushtimit të Bullgarisë, duket se zgjoi te Porta dëshirën shumë të justifikuar, që të ngushtojë sa më shumë, në kuptimin gjeografik, atë që mund të zgjerohet tepër, sidomos të shkëpusë një pjesë të bullgarëve të Lindjes, për t'i bashkuar me një provincë që ka rrethana krejt të ndryshme dhe përmes elementëve të atjeshëm etnikë heterogjenë të krijojë për vete mbikqyrës të besueshëm që të kontrollojë situatën politike. Kjo u arrit duke i dhënë Prishtinës Nishin dhe Pirotin me nja 210.000 bullgarë të Lindjes, meqenëse këta shumë vjet me radhë i përkisnin ish vilajetit të Prizrenit dhe njëkohësisht kishin qenë ndarë një herë prej bërthamës së popullit bullgar. Njëkohësisht, me provincën e Kosovës u bashkua sanxhaku i Shkupit me 129.000 bullgarë të Perëndimit, duke ua lënë arnautëve kujdesin që të qërojnë hesapet me të dy palët në rast se ata marrin pjesë në ndonjë lëvizje në provincat e Danubit dhe të Adrianopolit.

Ndarja e kombit bullgar në një gjysëm lindore dhe në një gjysëm perëndimore dhe dobësimi i të parës, është i justifikueshëm dhe oportuno jo vetëm nga pikëpamja e politikës së Portës, por ajo përmban edhe një bazë të shëndoshë për formime të reja eventuale në të ardh-

men dhe i përgjigjet edhe interesit austro-hungarez, sigurisht shumë më mirë se sa një Bullgari e Madhe, që mund të shtrihet në drejtimin perëndimor deri përtej Ohrit.

Është meritë edhe e Mithat Pashës që, me sa kishte mundësi, u parakujdes për kufizimin në radhë të parë e asaj pjese që vinte në konsideratë, sepse, sigurisht, mund të jetë vetëm e dobishme të shihet se kësaj lëvizjeje iu dha me kohë një përkufizim preciz.

Në se gjatë kufijve lindorë të sanxhakut të Shkupit, Seresit dhe Dramës shënohet një vijë demarkacioni deri në gjirin e Lagos-it, do të kemi përpara një territor, i cili, i zgjatur prej Thesalie dhe detit Egje, duke futur në të edhe sanxhakun e Selanikut dhe atë të Manastirit, deri në kufirin verior të Shkupit, përfshin të gjithë Bullgarinë Perëndimore ose maqedone. Për Bullgarinë e Lindjes supozohet vetvetiu se fatet e saj, herët a vonë, do të marrin rrugën sipas postulateve të Rusisë. Por një Bullgari e kufizuar vetëm në pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik do të humbiste shumë nga rrezikshmëria e saj, sidomos në qoftë se asaj i kundërvihet një Maqedoni bullgaro-greke në kufijtë e sipërshtënuar. Kjo, pa hyrë në relacione direkte me Greqinë ose me ndonjë shtet tjetër, do të futej si të thuash si një zonë neutrale midis Lindjes, [të Turqisë evropiane] që me përjashtim të Rumanisë dhe Trakisë juglindore natyrisht do t'i takonte sferës së dominimit rus dhe Perëndimit të Turqisë evropiane, që natyrisht anon nga sfera të tjera dominimi. Në një Maqedoni eventuale, elementët e atjeshëm grekë, në sajë të agilitetit dhe inteligjencës së tyre më të madhe do të mjaftonin gjithashtu për t'i mbajtur bullgarizmit ekuilibrin. Nga ana tjetër, shqiptarët do të kishin për detyrë të luftonin sllavizmin në provincën e Kosovës dhe përgjithësisht në të gjithë perëndimin e Gadishullit Ballkanik, aq më tepër pasi ata, nga vendbanimet e tyre të para në Alpet e Shqipërisë së Sipërme, prej kohësh e kanë populluar territorin deri në Moravën bullgare, e cila mund të jetë objekt aspiratash serbe në jug të Principatës [së Serbisë] dhe sigurisht do ta mbrojnë me këmbëngulje, në qoftë se ata kësaj here nuk lihen përsëri në baltë prej Evropës, sikundër ndodhi mjerisht në kohën e luftrave heroike të Skënderbeut kundër Portës dhe të detyrohen të prapsen para forcës së armëve ruse. Unë guxoj të bëj aluzion se ata këtë detyrë të tyre nën egidën e Austro-Hungarisë mund ta kryejnë jo vetëm spontanisht dhe me zell, por edhe në interes të perandorisë sonë, kur të vijë koha që Porta të mos jetë më në gjendje të mbajë në këmbë autoritetin në Gadishullin Ballkanik.

Mithat Pasha sigurisht nuk kishte qëllim të ndante dysh vendet e Hemus-it në interes të Evropës Perëndimore, ose veçanërisht të Austro-Hungarisë. Por mbasi ai me krijimin e provincës së Kosovës e pregatiti në fakt këtë ndarje, pikëmbështetja dhe impulset që jep ajo mund të konsiderohen sigurisht vetëm si një fitim për të gjithë rregullimet e mundshme në një të ardhme të afërt, ose më të largët dhe prandaj ato, sipas mendimit tim, nga pikëpamja jonë përbëjnë vlerën e vërtetë të formimit të ri të krijuar prej tij.

Në rrethanat e tanishme padyshim nuk mund të parashikohet nëse kjo krijesë do të jetë e qëndrueshme, por sigurisht do të na vinte keq po të ndodhte e kundërta, sepse do të ishte shumë e dëshirueshme që të mos preken përsëri kufijtë lindorë të Kosovës dhe të Selanikut, që i përgjigjen një kompromisi në gjeografinë politike të Gadishullit të Ballkanit.

Unë nuk e besoj që Prishtina do mund të qëndrojë si pikë qendrore e provincës së Kosovës, vetëm nëse Porta vendos të shpenzojë disa milionë për adoptimin e saj. Por pa u lënë ajo si seli e qeverisë provinciale, vilajeti, nga ana tjetër, si zor se mund të mbante emrin historik të Kosovës, për shkak të të cilit u zgjodh si kryeqytet pikërisht Prishtina dhe ku, si duket, e kishte hallin Mithat Pasha, sepse ai shprehu idenë politike që përfshihet në atë emër, gjë që pata nderin ta vë në dukje në raportin tim më 5 të këtij muaji. Po aq vështirësi të mëdha si ato financiare, zgjedhja e Prishtinës paraqet edhe për shkak se atje mungojnë elementët nga të cilët mund të merreshin anëtarët e këshillave të ndryshme qeveritare. Kjo kapërcehet vetëm në qoftë se valiu i zgjedh ata nga qytete të tjera, por në këtë rast ata duhet të marrin një rrogë të mjaftueshme, gjë që përsëri do të kishte vështirësitë nga ana financiare.

Këta anëtarë hë për hë u gjetën në Prishtinë. Por se çfarë kapacitetesh ka ndër ta, kjo kuptohet nga fakti që popullsia e vogël e Prishtinës, përveç disa bejlerëve shqiptarë të degjeneruar dhe klerikëve fanatikë famëkeqë, ka vetëm pak tregtarë të krishterë në kuptimin e zakonshëm më të gjerë dhe zyrtarë vendas të cilët përshtaten më parë për çdo gjë tjetër, se sa për nëpunës qeverie.

Do të ishte në interes të Portës, në qoftë se ajo do t'i kushton-te përsëri vëmendje rëndësisë së madhe strategjike të Prishtinës. Më përpara kësaj i jepej vazhdimisht rëndësi dhe qyteti ka qenë gjithnjë selia e një komandanti ushtrie. Por ka vite që nuk është më kështu. Mungesa e ndieshme e ujit në Prishtinë dhe në rrethin e saj mund të zh-

duket duke sjellë pa shumë shpenzime ujin e disa burimeve nga kodra në lindje të saj; pas kësaj ajo [Prishtina] e fortifikuar si duhet, mund të bëhet një “place d’arme” me një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse ajo është prej natyre pika kyçe e të gjitha komunikacioneve nga Rumelia dhe Bosnja, të cilat nga të gjitha drejtimet konvergojnë në fushën e Kosovës. Në qoftë se atje, për shembull, ndërtohet një kamp i fortifikuar i një ushtrie, që operon në drejtim të Kosovës, do të përbente jo vetëm një mbrojtje shpine shumë të mirë, por t’i jepte asaj në dorë linjat e operacioneve të armikut, të shpërndara gjithandej në distanca të shkurtëra, të cilat shpion kudo në qafa malesh dhe kalimesh që mund të mprohen lehtë. Nga pozicionet në Prishtinë mund të shmanget një ushtri armike që avancon nëpër Serbi për në Rumeli, d.m.th. nëpër grykën e Moravës dhe luginën e Moravicës që del në fushën e Moravës në drejtim të Leskovcit, nga Kumanova dhe Shkupi. Pastaj ajo mund të sulmohet pa shumë vështirësi nga ana e Prizrenit nëpër territorin e fushave kodrinore të dy Drenicave, që kalohet lehtë.

Komunikacionet e tjera, d.m.th. ai që shpie nga Bosnja mbi Sjenicë dhe Rogozna në Mitrovicë, ai që shpie nga Prizreni mbi Qafën e Dules dhe fushën e ngushtë të Carrelavës, ai nga Kurshumlia nëpër grykën e vështirë të veshur me pyje të Banjskës dhe ai nga Nishi dhe Leskovci nëpër grykën e Kaçanikut, shumë lehtë mund të bëhen të pakalueshëm dhe të mbrohen me pak mundime.

Në qoftë se unë kësaj ekspozije të shkurtër ushtarake i shtoj edhe konstatimin se vilajeti ka shumë nevojë për rrugë të mira, para së gjithash për disa që lidhin kryeqytetin e tij me linjën hekurudhore 10 km larg, pastaj për një administratë provinciale të vetëdijshme për misionin e saj, që do të sanonte dëmet kolosale që iu shkaktuan popullsisë së krishterë në vitin e kaluar, madje kjo do të ishte një detyrë e pashmangshme e saj, që do t’i hapte një fushë të gjërë veprimtarive të dobishme, atëherë besoj se i kam thënë të gjitha ato që duhen ditur mbi provincën e Kosovës.

Të njëjtin raport po ia dërgoj zotit të ngarkuarit me punë, banorit Herbert.

Pranoni..... Lippich

RECENSIONE

